

Dësë

Titull 2 • Numri 6 • Prill-Qershor 2014



Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun,

ATËHERË NDIQMËNI MUA

që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! (Ali Imran, 31)

şimşek®

Hayatın Tatlı Yanı...





Shi

Pa ty, horizontet i kaploi agimi i rremë
Pa ty, ra mëmëdheu që shtrihej kontinentesh
Pa ty, kalldrëmeve u rrëzuan ca shpirtëra të pambuktë

Je si hana, diejt në sytë e tuej shëndrisin,
Të dashuruem mbas teje si të marrë shëtisin...

Çdo pikë e jotja qiejt zbukuron... shi...

Ah sikur dorën time ta gjeja në të tanden
Bukuria në fytyrën time do të buzëqeshte...
Ah sikur edhe unë të përjetoja lumturinë e të arriturit ty

Ah sikur larg teje vetëm sa një hije
Ta shikojta fytyrën pafundësisht
Ah sikur të isha një shikim i përvuejtun për ty
Shi, e humbëm të gjithë thesarin e gjyshërve

Lagështia e syve të mi dashurues është për ty
Në mue përflaken trishtueshëm meloditë e ndarjes

Brumi i pashtershëm i mendimit që s'shuhet, je ti
Vështrimi yt si një shigjetë shpon errësirat
Universet me ty përbluhen, harmonia je ti

Me frymën tande do të vizatohen tablotë e jetës
Do të ndryshohen të gjitha çehret e njerëzisë
Me dritën tande do të ndriqohen bodrumet
Të gjitha nanat do t'i japin fëmijëve ujë nga ky shi.
Shi, me ty do shohin fundin thotësirat e universit
Ty të besojnë qiejt, nevojtarë për ty

SHI, AH SIKUR TË ISHA NJË GUR QË PRET PËR TY
NË MESIN E SHKRETINËS NJË ZOG I PËRMALLUEM PËR TY
NJË QËNDISJE E VOGËL QË TI PREKE
NJË SHIKIM I ETUN, I HEDHUN DREJT TEJE
NJË LOT QË RRËSHQET VRULLSHËM PËR TY
NJË ANDËRR E PAME PËR TY
NË KUPËN E TOKËS NJERI QË TË SHIKOI TY
NJË NGA KUREJSHËT MUHAXHIRE...



BOTUESI
Shtëpia Botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Erinda Kraja | Eva Kajti
Naile Sulaj | Verzana Nikshiqi

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

VITI: II
NUMRI: 5

Janar-Mars
2014

Përmblajtja



**Morali i të
Dërguarit të Allahut** 38
Melika Dogan



**E keqja
e dëmton të zotin** 22
Osman Nuri Topbash



**Mënyrat e
adhurimit të
Pejgamberit (a.s.)** 14
Selime Akburç

**Sa i ngjajmë njeriut
tonë të dashur?** 5
Halime Demireshik

**Një ditë e
Resulullahut** 8
Rukije Gjengly

**Disa rreze
drite nga jeta e
Pejgamberit (a.s.)** 17
Mehrap Bahar

**Një ditë me
Profetin** 24
Fatma Hale Liman

**Sa e duam
Resulullahun?** 28
Kybra Çoban

**Jemi me ty o i
Dërguari i Allahut** 30
Seher Ajdën

**Arkitekti i një brezi
të palëkundur,
Profeti besnik** 33
Shefika Kaja Meriç

**Muhamedi (a.s.)
në sytë
e Perëndimit** 36
Emine Bahçe



Halime Demiresbiq

Sa i ngjajmë njeriut tonë më të dashur?

Pejgamberi (a.s.), është njeriu më i përkryer ndër njerëzit që janë krijuar që nga krijimi i gjithësisë e që do të krijohen deri në Ditën e Kiametit.

Sipas një transmetimi të Imam Kurtubi, kjo e vërtetë është shprehur kështu:

"Bukuria e fytyrës së ndritur të Resulullahut nuk shfaqej plotësisht, sikur të shfaqeshin të gjitha bukuritë e Tij, sahabët nuk do të mundnin ta shikonin dot."

Xhabir bin Semure (r.a.), që mundohet të shprehë bukurinë e Tij të përsosur, thotë:

"Në një natë me hënë shikova Pejgamberin e nderuar, i cili kishte veshur një rrobë me ngjyrë të kuqe. Shikova një herë hënë dhe pastaj Atë për t'i krahasuar... Beto hem në Allah që sipas meje Ai ishte më i bukur se hëna."

Djali i xhaxhait i Pejgamberit, Ibn Abbasi (r.a.), tregon:

"Dhëmbët e parë të Pejgamberit (a.s.), ishin pak të ndarë dhe kur Ai fliste, dukej sikur në mes tyre rridhte dritë."

Nëna jonë Hz. Aishe ka thënë:

"Natën fytyra e Resulullahut shpërndante aq shumë dritë, sa kthehej në një hënë. Në errësirën e natës unë arrija të përshkoja gjilpërën nën dritën e fytyrës së Tij."


Një nga gratë që i është dorëzuar Resulullahut me të gjithë qënien e saj, nëna jonë Hz. Aishe (r.a.), e përshkruan bukurinë e të Dërguarit, duke e krahasuar me atë të Hz. Jusufit:

"Gratë që shikuan Jusufin (a.s.), prenë duart (pa e vënë re). Sikur ato të shikonin Resulullahun, do të prisnin mushkëritë dhe nuk do ta vinin re."

Ebu Hurejre (r.a.), e përshkruan kështu Pejgamberin tonë të nderuar:

"Nuk kam shikuar asgjë më të bukur se i Dërguari i Allahut. Në fytyrën e Tij sikur ndriçonte dielli me gjithë dritën e vet. Kur buzëqeshte, në mure përplasej dritë që dilte nga dhëmbët e Tij." (Tirmidhiu, Surati Meshjin Nebij; Ahmed bin Hanbel, Musned, vëllimi i tretë)

Ja se çfarë ka thënë Ummu Mabed (Atike binti Halid),





rreth bukurisë të Resulullahut:

"Kur e shikoja nga larg, më dukej më i bukur i njerëzve, kur e shikoja nga afër më dukej më i ëmbli i njerëzve." (Menahilus Safa)

Bera bin Azid (r.a.), e përshkruan kështu këtë bukurri qiellore, të cilën kishte pasur rastin ta sodiste vetë:

"Nuk kam shikuar kurrë (gjatë gjithë jetës sime) diçka aq të bukur sa Pejgamberi (a.s.), i veshur me rrobë të kuqe." (Muslim, Fedail. 92/2337)

Bukuria e Pejgamberit tonë ka qenë shumë e madhe, sa që fjalët nuk mjaftojnë që ta përshkruajnë atë. Fjalët kanë arritur që nga bukuria e Tij të përcjellin vetëm aq sa u tha më sipër.

Ne fatkeqësisht nuk kemi arritur ta shikojmë

dhe marrë shembull nga çdo aspekt. Ai është Pejgamberi i fundit dhe është bekuar me një moral të lartë. I Dërguari i Allahut është shprehur kështu, në lidhje me këtë temë:

"Mua më ka edukuar Zoti im, sa edukatë e mirë është ajo." (Sujuti, Xhamius Sagir, I, 12; Axhluni, Keshful Hafa, I, 70)

"Unë jam dërguar për të përsosur moralin e lartë." (Muvatta, Hysnyl Huluk, 8)

Hz. Aishe (r.a.), ua ka shpjeguar kështu moralin e Resulullahut njerëzve që e pyesnin:

"Moral i Tij ishte Kurani. Ai ishte dakord me gjërat që i pranonte Kurani dhe zemërohej me gjërat me të cilat zemërohej Kurani." (Muslim, Salatul Musafirin, 18)

Duhet të kemi parasysh se, nëse duam të përfitojmë nga drita e Tij e bekuar, duhet të ndjekim rrugën e Tij. Nuk ka asnjë rrugë që të jetë në kundërshtim me rrugën e Tij dhe që të na çojë në xhenet.

Le të marrim një pasqyrë shpirtërore dhe të shikohemi në të. Sa i ngjajmë ne Pejgamberit tonë të dashur?

Është e qartë se njeriu i ngjan atij që do. Kur rritet dashuria për dikë, ti ndryshon dhe i ngjan atij njeriu pa e vënë re... Syri dhe shpirti i njeriut të dashuruar është vetëm te njeriu i zemrës.

Le të shikohemi në pasqyrën shpirtërore dhe të gjykojmë se sa i ngjajmë Resulullahut! Sa i ngjajmë Atij nga ana e moralit, dhembshurisë, mirësisë dhe besnikërisë?

Le të shikojmë në pasqyrë dhe të kuptojmë se në cilën gradë është morali ynë!

A është gjuha jonë e butë dhe e kujdesshme si ajo e Pejgamberit tonë të dashur apo është e ashpër dhe i lëndon njerëzit?!

Po veshët tanë, a janë besnikë të Kuranit, si veshët e Resulullahut? A qetësohen veshët tanë me dëgjimin e Kuranit?!

Po mënyra e qëndrimit?! A ulemi siç bënte Pejgamberi (a.s.), i cili gjithmonë ishte i vetëdijshëm që

Le të shikohemi në pasqyrën shpirtërore dhe të gjykojmë se sa i ngjajmë Resulullahut! Sa i ngjajmë Atij nga ana e moralit, dhembshurisë, mirësisë dhe besnikërisë?

këtë bukurri hyjnore, por një pjesë e bukurisë së Tij vazhdon të jetë e pranishme në çdo gjë që Ai ka lënë pas.

Kjo bukurri nuk është materiale, por shpirtërore, pra është vetë shembulli dhe suneti i Tij... Edhe në Kuran Pejgamberi është cilësuar si **shembulli më i mirë**. Në Kuran thuhet:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun." (Ahzab, 21)

Duhet të kemi parasysh se Allahu nuk na kërkon të kemi si shembull njerëz të tjerë, qofshin këta edhe prindërit tanë; por ne duhet të ndjekim Atë, i cili është shembulli më i lartë i moralit...

Pejgamberi (a.s.), është i vetmi që duhet studiuar



ndodhej para Zotit dhe ashtu vepronte?! Si kalon dita jonë; a kalon gjithë dita jonë në mes punës, pazarit dhe obligimeve të ngjashme dhe kur vjen koha e namazit na pushton dembelizmi?! Natën Pejgamberi ynë falte namaz deri sa i enjtëshin këmbët. Sa prej nesh i kalojnë netët duke falur namaz? Le t'i lëmë adhurimet e natës; a i kryejmë me rregull detyrimet tona (farzet)? Mos jemi nga ata njerëz që thonë: "Unë jam besimtar, por nuk falem." apo "Tani nuk kam dëshirë të falem, do të falem pastaj!"

Le të shikojmë përmes pasqyrës rrobat tona... Vallë, po të ishte Pejgamberi pranë nesh sot, a do të kishim turp prej veshjeve tona? Sa mirë e njohim ne modestinë e Tij dhe kujdesin që tregonte në temat fetare?! Sa i ndjekin burrat dhe gratë rregullat e Islamit për sa i përket veshjes?! Sikur të na shikonte Resulullahu, a do të na nxihej fytyra nga rrobat tona të ngushta e të tejdukshme?! A do të fillonim të kërkonim justifikime për të shpëtuar nga turpi?! Po nëse Pejgamberi (a.s.), do të shëtiste me ne në rrugë, a do të shikonim kaq rehat haramin?!

Po ne gratë, a do të zbukuroheshim dhe të bënim grim para Pejgamberit (a.s.), ashtu siç bëjmë para njerëzve të huaj?

Po tavolinat tona, në çfarë gjendjeje janë? Le t'i sjellim pak ato pasqyra nga tavolinat tona. A janë ato tavolina, në të cilat nuk gjendet harami? Sa njerëz të varfër, sa komshinj, sa të afërm, sa fëmijë jetimë gëzohen nga ushqimet tona? A hamë ne duke kujtuar dhe falënderuar gjithmonë Atë që na i ka dhuruar të gjitha këto begati? Sa i ngjan tavolina jonë asaj të Pejgamberit (a.s.)? Sa herë jemi ulur në tavolinë vetëm kur na ka marrë uria; ashtu siç bënte Resulullahu? Sa herë jemi ngritur (ashtu siç bënte i Dërguari) pa u ngopur plotësisht? Sa herë në javë apo në muaj agjërojmë ne?

Sa vend zë Kurani në jetën tonë? Sa vetave prej nesh i janë zbardhur flokët kur kanë lexuar suren Hud... Sa prej nesh u bënë të sëmurë duke lexuar ajetet që kanë lidhje me fundin e botës? Sa ajete apo sure lexojmë në ditë? Sa përpiqemi të mësojmë

kuptimin e ajeteve të lexuar? Resulullahu nganjëherë, kur ishte duke ecur në rrugë, dëgjonte zërat e leximit të Kuranit që vinin nga shtëpitë e sahabëve dhe buzëqeshte. Po sikur të ecte në rrugë në ditët e sotme, çfarë zërash do të mbërrinin në veshët e Tij të bekuar?

Po shtëpitë tona, në ç'gjendje janë? Sa burra kapërdijnë zemërimin e tyre për të mos u bërtitur pjesëtarëve të familjes, ashtu siç bënte Pejgamberi ynë i mëshirshëm dhe i dashur? Sa burra i kushtojnë kohë familjes së tyre, ashtu siç bënte Pejgamberi (a.s.)? Sa prej nesh merren me edukatën e fëmijës? Sa prej nesh bisedojnë për tema fetare me familjen tonë? Sa prej nesh i bëjnë pyetje që kanë lidhje me fenë bashkëshortit të vet për të mësuar prej tyre? Sa burra i dëgjojnë problemet e grave dhe u japin zemër atyre? Sa burra bëjnë shaka me gratë e tyre? Sa gra tregojnë të njëjtin respekt dhe dashuri që tregonin gratë e Resulullahut ndaj Tij? Sa baballarë i afrohen derës së vajzës së tyre në mëngjes dhe i kujtojnë asaj botën tjetër, ashtu siç bënte Pejgamberi (a.s.), me Fatmën?

Po, të dashur lexues; ka shumë pyetje... Po ashtu, ka dhe shumë justifikime, probleme dhe shqetësime... Të gjitha këtyre jemi në gjendje t'u japim përgjigje, duke u shikuar në pasqyrën tonë. Të gjithë e kemi të qartë gjendjen tonë... Në fillim le të gjykojmë gjendjen tonë për të kaluar më pas tek njerëzit tanë të afërt, tek fqinjët dhe pjesëtarët e tjerë të shoqërisë sonë.

Kjo është një ftesë zemre... Ejani në rrugën për të njohur veten dhe për të ndihmuar të tjerët të njohin veten. Uroj që çdo ditë e më shumë t'i ngjasojmë Pejgamberit tonë të nderuar dhe t'i afrohem moralit të Tij të lartë.

"O Allah, na bëj ndjekës të Pejgamberit me fytyrë më të bukur se hëna dhe më mëshirë më të madhe se ujti i detit dhe oqeanit! Bëj që të jemi ndjekës të denjë të Tij!"



Rukije Gënyly

Një ditë e Resulullahut



Gjumi

Në Kuran, në ajetin e nëntë të sures Nebe thuhet:

“dhe gjumin jua kemi bërë për prehje.”

Në Kuran, gjendja në të cilën ne i kemi prerë të gjitha lidhjet me botën e jashtme quhet *gjendje e vdekur*, kurse momenti kur ne zgjohemi quhet *rilindje*.

E kanë pyetur Pejgamberin (a.s.):

-A flenë banorët e xhenetit?

Ai i ka dhënë këtë përgjigje:

- Gjumi është vëlla binjak me vdekjen; kurse banorët e xhenetit nuk vdesin!..

(Bejhaki, Shuabul Iman, IV, 183)

Po Pejgamberi (a.s.), kur dhe sa flinte? Si ishte gjumi i Tij?

Regjimi ditor i Pejgamberit (a.s.), nuk varej nga ora, por nga dielli. Kur perëndonte dielli, Ai nuk punonte më, ndërsa kur lindte dielli, Ai nuk flinte më. Koha e Tij e gjumit ishte në pjesën kohore mes namazit të jacisë dhe atij të sabahut. Në rastet kur nuk flinte aq sa kishte nevojë gjatë natës, flinte në mesditë, pas namazit të drekës.

Pejgamberi (a.s.), flinte gjithmonë në krahun e djathtë dhe e vendoste dorën e djathtë poshtë faqes. Edhe kur ishte në udhëtim, Ai flinte në krah të djathtë dhe e përdorte dorën e djathtë si jastëk. Kur pushonte vetëm pak shtrihej në shpinë.

Abdullah ibn Mesudi tregon këtë ngjarje:



Një ditë i Dërguari i Allahut ishte shtrirë për të fjetur mbi një qilim. Kur ishte zgjuar kishte vënë re se i kishin mbetur gjurmë në trup. Në atë moment kishte ardhur Hz. Omeri dhe i kishte thënë:

- O i Dërguari i Allahut!.. A nuk mund të flesh në një shtrat më të rehatshëm?!

Pejgamberi (a.s.), i kishte thënë:

- *Çfarë lidhjeje kam unë me këtë botë? Unë jam si një udhëtar që po udhëton në një ditë shumë të nxehtë dhe është ulur nën hijen e një peme për të pushuar!..* (Ahmed b. Hanbeli, Musned, I, 301; Tirmidhiu, Zyhd, 44; Ibn Maxhe, Zuhd,3)

Pejgamberi (a.s.), nuk pëlqente të shtrihet në bark; për këtë kishte thënë:

"Kjo mënyrë e të shtririt nuk është e pëlqyer nga Allahu." (Ibn Hanbel, IV, 388)

Shtrati i Pejgamberit (a.s.), nganjëherë ishte një copë lëkure, që kishte poshtë gjethe hurmash, nganjëherë ishte një mbulesë e palosur më dysh.

Sipas Hz. Aishe (r.a.):

"Resulullahu çdo mbrëmje para se të flinte thoshte suret Ihlas, Felek dhe Nas, pastaj i bashkonte duart dhe u frynte atyre; më pas prekte trupin e vet me duar. Në këtë mënyrë ai prekte në fillim kokën pastaj fytyrën për të vazhduar me gjoksin, krahët, gjunjët dhe pjesët e tjera që ndodheshin në pjesën e përparme të trupit. Këtë veprim e përsëriste tri herë." (Buhari, Fedailul Kuran, 14; Ebu Davud, Edeb, 98; Tirmidhiu, Deavat, 21)



Kur zgjohej në mëngjes

Pejgamberi ynë e fillonte kështu ditën e Tij:

"O Allah, me ndihmën Tënde arritëm mëngjesin; Me ndihmën Tënde arritëm mbrëmjen. Me Ty jetojmë dhe me Ty vdesim. Ringjallja është vetëm për tek Ti." (Buhari, Deavat, 7, 8 ; Muslim, Zikr, 59; Ebu Davud, Edeb, 97, 98)

Sipas një transmetimi tjetër, Pejgamberi (a.s.), kishte këshilluar leximin e kësaj duaie në mëngjes:

"Kemi pranuar për Zot Allahun, për fe Islamin, për të Dërguar Pejgamberin (a.s.)."

"Kur njëri nga ju zgjohet nga gjumi, të mos prekë asnjë gjë pa i larë duart tri herë, pasi nuk mund ta dijë se çfarë ka prekur gjatë natës." (Buhariu)

Në një nga transmetimet është shtuar edhe larja e hundës tri herë. Pejgamberi ynë për këtë temë ka thënë:

"Kur njëri nga ju zgjohet nga gjumi, le të lajë hundën tri herë. Natën shejtani fle brenda hundës suaj." (Buhariu)



Rregullat që duhen zbatuar në banjo

Pejgamberi (a.s.), kur hynte në banjo, thoshte:

“O Allah!.. Më mbro mua nga papastërtia dhe nga krijesat e dëmshme.”

Kur dilte nga banjoja, thoshte:

“Falënderoj Allahun që më pastroi nga gjërat që më dëmtojnë mua.” (Buhari)

Pejgamberi (a.s.), kur hynte në banjo e mbulonte kokën.

Kur ishte në banjo nuk fliste dhe nuk kthente përshëndetjen. Hz. Omer ka thënë:

“Resulullahu një ditë ishte në banjo dhe një njeri i dha selam. Pejgamberi nuk ia ktheu përshëndetjen. Pastaj i tha atij njeriu: “Nuk më duket e arsyeshme që të adhuroj Allahun kur jam i papastër!” (Muslimi, Ebu David)

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Kur të shkoni në banjo, mos u ktheni nga Kibla as mos ia ktheni shpinën asaj. Ktheni fytyrën tuaj nga lindja ose nga perëndimi.” (Buhari)

Mënyra e ecjes

Pejgamberi (a.s.), nuk i tërhiqte këmbët kur ecte, ai i ngrinte këmbët nga toka. Nuk e kishte zakon të shikonte majtas apo djathtas kur ishte në lëvizje. Ai përkulej pak përpara sikur po ecte në një terren me ulje e ngritje. Nuk rrinte drejt në mënyrë që të linte gjoksin përpara. As nuk ecte me hapa vrapimi. Ishte një bekim i Zotit që Ai të kalonte largësi të mëdha në një kohë të shkurtë.

Pejgamberi (a.s.), i jepte shumë rëndësi mënyrës së ecjes. Ai e përmendte shpesh faktin që mënyra e ecjes ndikon në veshje ndërsa veshja ndikon në karakterin e njeriut. Kur Ai kishte shikuar një grua që po ecte si burrë, duke mbajtur në shpinë çantën e shigjetës dhe të harkut të burrit të vet, tha:

“Gratë që mundohen t’u ngjasojnë burrave dhe burrat që mundohen t’u ngjasojnë grave, nuk janë prej nesh.” ose *“Allahu i ka mallkuar ato.”* (Shiko: Buhari, Libas, 61)

Ebu Hurejra (r.a.), ka thënë:

“Nuk kam parë njeri të ecë më shpejt se Pejgamberi ynë i nderuar. Kur Ai ecte, toka poshtë këmbëve të Tij rrokullisej. Ne të tjerët përpiqeshim shumë të mos mbeteshim prapa kur ecnim pas Tij.”

Hz. Ali (r.a.), ka thënë:

“Resulullahu kur ecte, i ngrinte këmbët fort sikur të ishte duke zbritur në një rrugë të pjerrët.”

Hz. Aliu ka thënë gjithashtu:

“Resulullahu (a.s.), nuk ecte me krenari dhe me gjoks përpara, as nuk tundej sa majtas- djathtas, ai përkulej pak përpara sikur të ishte duke zbritur në një rrugë të pjerrët.”

Mënyra e uljes

Kajle Binti Mahreme (r.a.), e tregon kështu mënyrën se si është ndjerë herën e parë që ka shikuar Resulullahun:

“Kur e shikova të Dërguarin e Allahut të ulur në një mënyrë të thjeshtë dhe modeste, trupi im filloi të dridhej nga gjendja e Tij shpirtërore.”

Ebu Said el- Hudri tregon:

Pejgamberi (a.s.), ulej galiç. Është transmetuar:

“Pejgamberi ynë i nderuar, pasi falte namazin e sabahut, ulej galiç deri në lindjen e plotë të diellit.” (Ebu Davud, VI, 363)



Mënyra e ngrënies

Sipas transmetimit të sahabit Ebu Umame (r.a.), Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Zoti im më ka ofruar kthimin e gjithë luginës së Mekës në ar. Kësaj ftese unë i jam përgjigjur kështu:

"Jo, o Zoti im!.. Unë mund të duroj i uritur kur duhet dhe të ngopem kur duhet. Kur jam i uritur do të të lutem Ty dhe do të kujtoj Ty; kur të jem i ngopur do të të falënderoj Ty dhe do të lutem me përgjërëm."

Nëna jonë Hz. Aishe ka thënë:

Pejgamberi (a.s.), më ka thënë:

"O Aishe, sikur unë të doja, pas meje do të vinin male prej ari. Një engjëll më ka thënë":

"Ke selamin e Zotit Tënd. A dëshiron të jesh Pejgamber mbret apo Pejgamber rob (i thjeshtë)?"- të pyet Ai."

Xhebraili që ndodhej pranë këtij engjëlli, më këshilloi të isha modest. Unë i thashë që dëshiroja të jetoja si një pejgamber rob."

Hz. Aishe e ka vazhduar kështu tregimin e kësaj ngjarjeje:

"Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), u ul përsëri galiç në sofër, nuk hëngri asgjë dhe tha:

"Unë ha si një njeri normal dhe ulem si një rob."

Pejgamberi ynë i nderuar hante vetëm dy vakte në ditë. Nuk kemi hasur askund që Ai të ketë ngrënë tre vakte. Zakonisht hante hurma, kur kishte mundësi pinte dhe qumësht. Kishte shumë dëshirë të ndante ushqimin me të tjerët. Ai hante duke qëndruar me gjunjë në tokë dhe e fillonte ushqimin me Bismillah gjithmonë. Për këtë, Ai ka thënë:

"Unë jam rob, si i tillë ha dhe pi."

Ai i jepte shumë rëndësi vaktit të akshamit dhe për të treguar vlerën e tij ka thënë:

"Qoftë edhe me një grusht hurma mos e lini pas dore vaktin e akshamit, sepse lënia pas dore e këtij vakti e plak njeriun dhe i prish ekuilibrin e organizmit." (Tirmidhiu, IV, 287, 1856; Ibn Maxhe, II, 1113)

Abdullah ibn Abbas (r.a.), tregon:

"Resulullahu (a.s.), ka fjetur disa ditë pa ngrënë asgjë. As familja e Tij nuk kishte ushqim në aksham. Në të shumtën e kohës ata hanin ushqim të bërë vetëm nga elbi." (Tirmidhiu, Zuhd, 38; Ibn Maxhe, Etime, 49)

Nëna jonë Hz. Aishe ka thënë:

"Hz. Pejgamberi (a.s.), që nga dita kur erdhi në Medinë deri në ditën kur ndërroi jetë, asnjëherë nuk është ngopur tri ditë rresht me bukë gruri." (Buhariu, Etime, 1; Muslimi, Zuhd, 20; Nesai, Dahaja, 37)

Pejgamberi na ka këshilluar të jemi të balancuar kur hamë:

"Njeriu nuk ka mbushur asnjë enë më të keqe sesa barkun e tij. Në fakt, një njeriu i mjaftojnë disa kafshata për të qëndruar në këmbë. Nëse me patjetër dëshiron të hajë më shumë, atëherë një të tretën e stomakut ta mbushë me ushqim, një të tretën me ujë dhe një të tretën tjetër ta lërë bosh si pjesë e egos."

Enes bin Malik (r.a.), tregon:

"Pejgamberi ynë deri në ditën e fundit të Tij në këtë botë, nuk ka ngrënë në tavolinë të lartë, nuk ka ngrënë as bukë të bërë nga mielli i thjeshtë."

Pejgamberi (a.s.), nuk e miratonte ushqimin e nxehtë:

"Në ushqimin e nxehtë nuk ka bollëk. Allahu nuk na detyron të hamë zjarr, prandaj ftoheni ushqimin tuaj."

Resulullahu e hante ushqimin me dorë dhe me tre gishta, radhë përdorte dhe gishtin e katërt si ndihmës. Ai gjithmonë hante pjesën e ushqimit që kishte përpara.

Ebu Hurejre (r.a.), ka thënë:

"Pejgamberi (a.s.), nuk kishte naze ndaj ushqimeve. Nëse kishte uri, Ai e hante ushqimin që kishte përpara, nëse nuk kishte uri nuk e hante." (Buhariu, Menakib, 23; Muslim, Eshribe, 187; Ebu Davud, Etime, 13)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Të kërkosh të hash çdo gjë që të vjen në mendje, konsiderohet shpenzim i tepërt." (Ibn Maxhe, II, 1112, 3552)

Ushqimet e Tij të preferuara

Një ditë Pejgamberi (a.s.), ishte në dhomën e Hz. Aishes dhe i tha asaj:

- *A ka ndonjë gjë për të ngrënë?*

Nëna jonë Hz. Aishe iu përgjigj:

- Bukë, hurma dhe uthull...

Pejgamberi i tha:

- *Sa e mirë është uthulla. O Zot bekoje uthullën. Ajo përdorej edhe nga pejgamberët para meje. Një shtëpi në të cilën gjendet uthull nuk mbet në gjendje të keqe.*" (Ibn Maxhe)

Pejgamberi (a.s.), i donte ushqimet me mish dhe ka thënë:

- *Mishi është ushqimi më i mirë i njerëzve të kësaj bote dhe të xhenetit.*

"Kur hante mish nuk e përkulte kokën drejt mishit, e afronte mishin drejt gojës dhe e hante duke e kafshuar. Ai pëlqente kofshën dhe këmbën e dhenve. Pejgamberi e fshinte me gishta ushqimin duke thënë: *"Fundit i ushqimit ka më shumë bereqet."* (Ihja, II, 371; Bejhaki)

Enes bin Malik tregon:

"Pejgamberi (a.s.), e pëlqente shumë ushqimin e bërë nga kungulli. Sa herë që sillnin një ushqim të bërë nga kungulli ose kur na ftonin për të ngrënë një ushqim që përmbante edhe kungull, duke qenë se e dija që i pëlqente kungulli; i zgjidhja kungujt dhe ia vendosja Pejgamberit përpara."

Një hadith tjetër thotë:

"Pejgamberi ynë e donte shumë kungullin, për të thoshte: *"Kungulli është perimja e vëllait tim Yunus."*

"Ai e hante ushqimin e zogut që ishte gjuajtur, por vetë nuk dilte për gjah." (Ibn Maxhe, Etime, 62)

Sipas nënës sonë, Hz. Aishe, Pejgamberi i nderuar i donte shumë ëmbëlsirën dhe mjaltin.

Enes bin Malik ka thënë:

"Pejgamberi (a.s.), e pëlqente shumë ushqimin e mbetur në fund të tenxheres."



Edukata në sofër

Një grup njerëzish e pyetën Pejgamberin (a.s.):

"O Resulullah! Ne hamë, por nuk ngopemi dot!"

Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj:

"Ju me siguri e hani ushqimin pjesë-pjesë!"

Ato e pohuan.

Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha:

"Atëherë, uluni në sofër dhe filloni duke bërë Bis-milah. Do të shikoni që Allahu do ta rrisë bereqetin e ushqimit tuaj." (Ibn Maxhe, II, 1093, numër: 3286)

Në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:



Pastërtia

Në fetë paraardhëse nuk ekzistonte zakoni i larjes së duarve. Këtë zakon e ka sjellë për herë të parë pejgamberi i fundit, Muhamedi (a.s.). Ashu siç lahen duart gjatë marrjes së abdestit, ashtu duhen larë edhe para ushqimit. Larja e duarve para ushqimit quhet si abdesti i ushqimit. Në hadith thuhet:

“Nëse i ndodh gjë gjatë natës një njeriu që bie të flejë pa i larë duart pas ushqimit, le ta kërkojë arsyen e kësaj tek vetja, askund tjetër.” (Buhari, Edebul Mufred)

Sipas të dhënave që kemi nga Ibn Sad dhe Tirmidhiu, Pejgamberi (a.s.), mbante gjithmonë një shami pranë. Atë e përdorte kur merrte abdest ose kur lante duart. (Ibn Sad, Tabakat, I, 462; Tirmidhiu, Sunen, I, 74-77, numer 53-54)

Selman Farisi (r.a.), tregon:

“Kam lexuar në Teurat se larja e duarve pas bukës shton begatinë e ushqimit. Kur ia kam thënë këtë gjë Pejgamberit tonë, Ai më tha:

“Begatia e ushqimit shtohet kur lahen duart edhe para edhe pas ushqimit.”

“Për sa kohë që tryeza të jetë e shtruar, askush të mos ngrihet nga sofra, edhe nëse është ngopur. Mos të largohet nga sofra për të mos i turpëruar të tjerët.” (Ibn Maxhe, II, 1096, numër: 3295)

Esma binti Jezid tregon:

Resulullahu na ftoi të uleshim në sofër.

Ne i thamë:

- Nuk kemi uri, jemi të ngopur!..

Pejgamberi na tha:

- *Mos e bashkoni gënjeshtërinë me urinë!* (Ibn Maxhe, II, 1097, numër: 3298)

Omer bin Seleme tregon:

“Unë jam një fëmijë që jam rritur në duart e Pejgamberit (a.s.). Kur haja, e lëvizja dorën rreth pjatës.

Pejgamberi më këshilloi:

- Biri im, fillo me Bismilah, ha me dorë të djathtë dhe vetëm nga pjesa që ke përpara!

Që nga ajo ditë, unë kam ngrënë ashtu siç Ai më këshilloi.” (Buhari, Etimë, 2 ; Muslim, Eshribe, 108)

Ebu Said el - Hudri (r.a.), tregon:

Pejgamberi ynë, pasi çohet nga sofra thoshte:

“Falënderuar qoftë Allahu që bëri që ne të ngopemi dhe që na ka bërë prej myslimanëve.”

Sipas transmetimit të Enes bin Malikut, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Allahu është i kënaqur nga njeriu që falënderon Zotin pas ngrënies dhe pas pirjes së ujit.”



Selime Akburç

Mënyrat e adhurimit të Pejgamberit

-Salallahu alejhi ve selem-

Enes bin Malik (r.a.), na tregon :
Tre sahabë shkuan të pyesnin gratë
e Pejgamberit (a.s.), mbi adhurimet
që Ai kryente fshehurazi në shtëpi.

Kur i mësuan, thanë:

- A jemi ne si Pejgamberi (a.s.)?!

Allahu ia ka falur Atij të gjitha
gjynahet.

Njëri prej tyre tha:

-Unë gjatë gjithë jetës sime nuk do
të fle asnjë natë,
vetëm do të fal namaz.

Një tjetër tha:

- Unë do të agjëroj gjatë gjithë jetës
sime!..

Sahabi i tretë tha:

- Unë do të rri larg grave,
nuk do të martohem kurrë!..

Pas pak kohe, Pejgamberi ynë i
nderuar shkoi pranë tyre dhe u tha:

*"A jeni ju që i keni thënë këto fjalë?
Pasha Allahun, askush nga ju nuk
e ka frikë Allahun më shumë se unë
dhe asnjëri nga ju nuk e respekton
Atë më shumë se unë! Megjithatë
edhe unë disa ditë agjëroj, disa ditë
nuk agjëroj. Natën edhe falem edhe
fle. Unë martohem. Ai që ia sjell
shpinën sunetit tim, nuk është prej
ndjekësve të mi."*

(Buhari, Nikah, 1)



Adhurimet e natës

Pejgamberi ynë i nderuar ishte shumë i dhënë pas adhurimeve
të natës. Ai ka thënë:

*"Allahu ka bërë që çdo pejgamber të dojë shumë diçka. Gjëja që
unë dua më shumë janë adhurimet e natës."* (Hejthem, II, 271)

Ai vetë i donte shumë adhurimet e natës dhe ua këshillonte
edhe ndjekësve të vet:

*"Ju lutem, bëni përpjekje për t'u ngritur natën, sepse ajo ka
qenë mënyra e njerëzve të mirë, që kanë jetuar më përpara, për
t'u afruar më Allahun (xh.sh.). Ky lloj adhurimi të largon nga
mëkatet, është shpagues i gabimeve dhe largon shqetësimet nga
trupi."* (Tirmidhiu, Deavat, 101)

*"Çohuni nga gjumi natën dhe falni namaz, zgjoni edhe gratë
tuaja; nëse nuk zgjohen, Allahu i mëshiroftë ata që i zgjojnë duke
i stërpikur me pak ujë në fytyrë. Në të njëjtën mënyrë, Allahu e
mëshiroftë gruan e cila e zgjon burrin e saj natën për të falur
namaz."* (Ebu Davud, Tatavuu, 18)



Adhurimet e natës fillojnë me namazin e jacisë. Rëndësinë e këtij namazi Ebu Berze el Eslemi (r.a.), e ka shpjeguar kështu:

“Resulullahu (a.s.), nuk pëlqente gjumin përpara namazit të jacisë dhe nuk pëlqente të folurit pas këtij namazi.” (Buhari, Mekavit, 13)

Djali i xhaxhait të Resulullahut, Abbas (r.a.), transmeton:

“Pejgamberi ynë i nderuar ka falur njëmbëdhjetë rekat namaz gjatë natës.” (Buhari, Ezan, 15; Muslim, Musafirin, 121, Ebu Davud, Tatavvu, 26; Tirmidhiu, Mevakit, 208)

Ja si e ka përshkruar nëna jonë Aishe, kënaqësinë që merrte Pejgamberi i nderuar nga falja e namazit të natës :

“Pejgamberi (a.s.), pjesën më të madhe të natës e kalon me adhurime, lexon suret e gjata të Kuranit : “Bekare, Imran, Nisa”. Kur vinte radha e ajeteve të frikshëm, Ai kërkonte shpëtim nga Allahu. Kur vinte radha e ajeteve që tregonin për të mirat që na ka dhuruar Zoti, Ai i lutej Allahut që të ishte nga njerëzit që përfitojnë nga këto të mira.” (Ibn Maxhe)

Pejgamberi (a.s.), i lexonte me zë të lartë ajetet e Kuranit, njerëzit përreth e dëgjonin shumë qartë. Nganjëherë gjatë leximit ai kalonte në një gjendje emocioni të lartë. Evu Zer (r.a.), tregon:

*“Kur Pejgamberi (a.s.), lexoi shpjegimin e ajetit: **“Nëse Ti i dënon ata, robërit e Tu janë e, nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i urti.”*** (Maide, 118) u ndikua aq shumë nga ky ajet, sa e përsëriti këtë ajet deri në mëngjes.”

Abdullah ibn Shihhir (r.a.), e tregon kështu gjendjen që përjetonte Resulullahu gjatë adhurimit të Allahut:

“Një herë kisha shkuar pranë Resulullahut. Ai po falej. Në atë moment Ai po qante dhe nga gjoksi i Tij vinte një zë që ngjan me zhurmën që bën një kazan në zierje.” (Ebu Davud, Salat, 156)

Adhurimet nafile (shtesë)

Ebu Hurejra (r.a.) ka transmetuar këto fjalë të Resulullahut:

“Allahu i lartë ka thënë: ‘Nuk ka asgjë më të bukur se kryerja e adhurimeve që i kam bërë të detyrueshme me qëllimin për të m’u afruar Mua. Robi im me adhurimet nafile (shtesë) më afrohet më shumë dhe derisa arrin në një gjendje të tillë, në të cilën Unë e dua atë. Në momentin që Unë e dua atë, Unë bëhem veshi që ai dëgjon, syri që ai shikon, dora që mban gjërat, këmba që ecën, zemra që e ndihmon për të kuptuar dhe gjuha që e ndihmon për të folur. Nëse ai kërkon diçka prej Meje, Unë ia jap patjetër. Nëse kërkon shpëtim tek Unë, e mbroj nga çdo lloj rreziku.” (Buhari)

“Namazi nafile më i dobishëm është namazi i falur në shtëpi.” (Buhariu, VII, 99)

“Një pjesë të namazeve tuaja falini në shtëpi; mos lejoni që ato të kthehen në varre.” (Buhariu, II, 56)

Agjërimi

Pejgamberi ynë i nderuar u ka dhënë shumë rëndësi agjëtimeve të tjera, përveç atyre që janë të detyruara dhe i ka këshilluar edhe të tjerët të agjërojnë. Disa nga hadithet që kanë lidhje me këtë temë janë këto:

“Njeriu që agjëron gjatë gjithë Ramazanit dhe që i shton kësaj edhe agjërimin e gjashtë ditëve në muajin Shevval, është sikur të ketë kaluar të gjithë vitin me agjërim.” (Muslim, Sijam, 204)

“Kam shpresë se agjërimi i ditës së Ashures bën që të falen të gjitha gjynahet e vitit të mëparshëm.” (Tirmidhiu, Savm, 48)

“Punët i ofrohen (paraqiten) Allahut ditën e hënë dhe të enjte. Unë kam dëshirë që këto punë të ofrohen kur unë jam agjërueshëm.” (Tirmidhiu, Saum, 44)

Këshillohet agjërimi në ditët e 13, 14 dhe 15 të muajit të hixhretit. Ibn Abbas (r.a.), ka thënë:

“Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), agjëronte gjithmonë gjatë këtyre 3 ditëve, edhe kur ishte në udhëtim agjëronte.” (Nesai, Savm, 70)

Aishja (r.a.), e ka shpjeguar kështu mënyrën e agjërimin të Pejgamberit (a.s.):

Resulullahu (a.s.), nganjëherë agjëronte aq shumë brenda një muaji, sa ne thoshim: “Këtë muaj nuk do bëjë iftar



asnjëherë!" Në disa muaj të tjerë nuk agjëronte dhe ne thoshim: "Këtë muaj nuk do të agjërojë më!" Unë nuk di që të ketë agjëruar për gjatë gjithë muajit asnjëherë (përveç Ramazanit). Nuk kam parë të agjëronte asnjë muaj tjetër më shumë se në muajin e Shabanit. Ai ka thënë:

"Adhuroni Allahun aq sa mundeni!.. Kur ju nuk përtoni, as Allahu nuk përton!.."

Resulullahu i këshillonte njerëzit që namazet nafile, edhe pse të pakta, të ishin të vazhdueshme. Edhe vetë Ai, kur fillonte të falte një namaz shtesë e vazhdonte këtë gjë.

Në një hadith tjetër, nëna jonë Aishe na e tregon kështu mënyrën si e kishte kaluar natën e Kadrit Resulullahu:

"Kur vinin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Resulullahu i përkush-tohej plotësisht adhurimit. Ai adhuronte Allahun gjatë gjithë natës dhe e zgjonte dhe familjen për të bërë adhurim." (Ebu Davud, Ramazan, 1)

Më bujari i njerëzve

Abdullah ibn Abbasi (r.a.), thotë:

"Resulullahu ishte më bujari i njerëzve. Ditët kur Ai ishte më bujar, ishin ditët e Ramazanit kur takohet me Xhebrailin (a.s.). Pejgamberi takohet me Resulullahun në çdo natë të Ramazanit dhe i lexonin Kuran njeri- tjetrit. Për këtë arsye, në ditët kur takohet me Xhebrailin, Pejga- mberi ishte më bujar se era e begatë që sjell shiun." (Nesai, Sijam, 2)

Ebu Dher (r.a.), tregon:

Një ditë në kohën e muzgut po shëtisnim me Pejgamberin (a.s.), në rrethinat e Medinës. Përpara na doli mali Uhud. Resulullahu më tha:

- O Ebu Dher!

Unë iu përgjigja:

- Urdhëro, o i Dërguari i Allahut, jam në shërbimin tënd!

Resulullahu më tha:

- Sikur mali i Uhudit të kthehet në ar dhe të më jepej mua, nuk do të doja që të mbaja më shumë se tre ditë as një dinar të asaj pasurie. Edhe atë një dinar do ta ndaja për të paguar borxhet.

Pastaj Resulullahu tha:

"Edhe ato që kam dua t'ia shpërndaj robërve të Allahut kështu!..", ndërkohë bëri shenjë me dorë sikur po shpërndante lekë djathtas, majtas, përpara dhe prapa.

Pas kësaj shtoi:

- Ebu Dher!

Unë iu përgjigja:

- Urdhëro, o i Dërguari i Allahut, jam në shërbimin tënd!

Ai e vazhdoi kështu fjalën e Tij:

"Ata që zotërojnë shumë pasuri në këtë botë, kanë sevape pak në xhenet. Veç ata që e shpërndajnë pasurinë nuk janë prej tyre. Por njerëzit e tillë janë të paktë!" (Muslim, Zekat, 32)

Mënyra e dëgjimit të Kuranit

Abdullah ibn Mesud tregon:

Një ditë Resulullahu më tha mua:

- O Ibn Mesud! Më lexo mua Ku- ran!

Unë i thashë:

- Në një kohë kur Kurani të është zbritur Ty, pse të lexoj unë Kuran Ty, o i Dërguar?!
- Mua më pëlqen shumë të dëgjoj Kuran nga të tjerët.

- Pas kësaj, unë fillova t'i lexoj Atij suren Nisa:

"Si do të bëhet kur prej çdo po- pulli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty (o Muhamed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!"

(Nisa, 41)

"Për momentin mjafton!"
Unë ngrita kokën dhe shikova, po qante me ngashërim." (Buhari, Tefsir, 4/9)

Kur diçka nuk e do Allahu

Një herë Resulullahu kishte thënë:

- Askush nuk mund të futet në xhe- net në sajë të punëve dhe adhurimeve të tij!

Shokët e Tij e kishin pyetur me çudi:

- As ju, o Resulullah?

- Po edhe unë!.. Nëse nuk më ndih- mon Zoti im!.. Po nuk më përfshiu mëshira dhe falja e Zotit, as unë nuk futem në xhenet! Punët që kam bërë nuk më shpëtojnë as mua!.. (Buhari, Rikak, 18)



Disa rreze drite

NGA JETA E PEJGAMBERIT

- sal-lallahu alejhi ve sel-lem-

Mehtar Babar

MBAJTJA E MBESËS NË SHPINË

Ebu Katade el- Ensari (r.a.), tregon:

"Resulullahu falte namazin duke mbajtur në shpinë në fëmijën me emër Umame, që ishte vajza e Zejnepit dhe Ebul Asit. Kur mbërrinte në ruku e merrte vajzën për ta ulur në tokë, bënte rukun dhe sexhden dhe e merrte vajzën përsëri në shpinë teksa ngrihej." (Buhari, Salat, 106)

NË SHËRBIM TË FAMILJES SË VET

Aishja (r.a.), thotë:

"Një ditë më pyetën mua: 'Çfarë bën Resulullahu në shtëpi?' Iu përgjigja: 'Qëndron në shërbim të familjes së vet, rregullon këpucët e veta.' Kur vinte koha e namazit drejtohej për në namaz." (Buhari, Ezan, 44)

DETYRA E SECILËS DORË ËSHTË E VEÇANTË

Aishja (r.a.), thotë:

"Resulullahu mendohej ta bënte çdo punë me dorën e djathtë (kur kishte mundësi); duke u pastruar, duke krehur flokët, duke veshur këpucët ai fillonte nga e djathta gjithmonë. Dorën e djathtë e përdorte për pastrim dhe për ushqim. Dorën e majtë e përdorte për pastrimin në banjo dhe për gjëra të tilla të ngjashme." (Buhari, Vudu, 31)

NËSE NAMAZI I DILTE NGA KONTROLI

Ebu Hurejra (r.a.), tregon:

Një ditë Resulullahu hyri në xhami dhe u ul në një qoshe. Ne uleshim rreth Tij. Në atë moment,



erdhi dikush dhe filloi të falej. Burri nuk e dinte, por Pejgamberi po e vështronte. Pasi përfundoi faljen e namazit, ai erdhi pranë Pejgamberit dhe e përshëndeti me selam. Pejgamberi ia ktheu përshëndetjen dhe i tha:

- *Kthehu dhe fal edhe një herë namazin, sepse ti nuk e fale atë namaz!*

Njeriu u kthye mbrapsht dhe fali namazin ashtu siç kishte bërë më përpara. Pastaj erdhi pranë të Dërguarit dhe e përshëndeti me selam. Resulullahu përsëri i tha:

- *Kthehu dhe fal edhe një herë namazin, sepse ti nuk e fale atë namaz!*

Kjo gjë u përsërit tri herë. Më në fund, burri i tha:

- Beto hem në Allahun që të ka dërguar Ty për të sjellë të vërtetën që unë nuk di të fale m ndryshe. Më mëso mua mënyrën e drejtë për të falur namaz!..

Pas këtyre fjalëve, Resulullahu i tha:

"Në momentin që fillon të falesh, merr tek bir. Pastaj thuaj pjesë nga Kurani aq sa ke mundësi. Pastaj bëj ruku dhe qëndro ashtu deri kur të gjitha organet do të qëndrojnë në gjendje të palëvizshme. Pastaj ngrije kokën, qëndro deri sa të drejtohesh mirë. Pas kësaj, bëj sexhde, qëndro në sexhde deri në momentin kur të gjitha organet të qëndrojnë të palëvizshme. Pastaj ngrije kokën, rri i ulur derisa të gjitha organet të qëndrojnë të palëvizshme. Bëj kështu në të gjitha rekatet e namazit." (Buhari, Ezan, 95)

ÇFARË DUHET THËNË PAS NAMAZIT?

Muaz (r.a.), tregon :

Një ditë Resulullahu më mbajti dorën dhe më tha:

- Muaz! Beto hem në Allah se unë të dua ty!

Edhe unë i thashë Atij:

- O i Dërguar i Allahut!.. Edhe unë betohem në Allah që të dua Ty.

Resulullahu e vazhdoi kështu fjalën e Tij:

- *Muaz! Të këshilloj të thuash këtë dua pas çdo*

namazi: "O Zoti im! Më ndihmo që të kujtoj Ty dhe të të adhuroj, të jem falënderues për të mirat që më ke dhënë, të adhuroj Ty ashtu siç Ti e meriton." (Ebu Davud, Vitr, 26)

LUTJA QË DUHET BËRË KUR DEL NGA SHTËPIA

Nëna jonë Ummu Seleme ka thënë:

"Kur dilte nga shtëpia, Resulullahu shikonte drejt qiellit dhe thoshte: 'Po dal me emrin e Allahut, unë i besoj Atij. Zoti im! Kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos shkoj në humbje e as dikush të mos më dërgojë në humbje; kërkoj mbrojtjen Tënde të mos rrëshqas (nga e vërteta); kërkoj mbrojtjen Tënde të mos dëmtoj askënd e as dikush të mos më dëmtojë mua; kërkoj





mbrojtjen Tënde të mos injoroj askënd e askush të mos më injorojë mua.” (Ebu Davud, Edeb, 102)

DUART DHE AROMA

Enes bin Malik (r.a.), tregon:

“Unë nuk kam prekur asnjë copë, asnjë pambuk më të butë se duart e Resulullahut. Gjatë gjithë jetës sime nuk kam ndjerë asnjë aromë më të mirë se era e Tij.” (Muslim, Fedail, 81)

NJË HERË TË PAKTËN

Enes ibn Malik (r.a.), tregon:

Resulullahu nuk kishte shërbëtor kur shtegtoi për në Medine. Njerku im Ebu Talha më kapi nga dora dhe më çoi pranë të Dërguarit:

- O i Dërguari i Allahut! Enesi është një fëmijë i zgjuar, le të të shërbejë!”

Unë i shërbeva Resulullahut për dhjetë vjet me radhë, edhe kur ishte në udhëtim edhe kur nuk ishte. Nuk më tha mua asnjëherë as: “Ufff!” Nuk më tha asnjëherë: “Pse e bërë kështu”, për diçka që kisha bërë; ashtu siç nuk më tha: “Pse nuk e bërë kështu?”, për gjërat që nuk kisha bërë. (Buhari, Vesaja, 25; Ebu Davud, Edeb, 1; Tirmidhi, Birr, 69)

A NUK E KENI DËGJUAR?

Xhabir ibn Abdullah (r.a.), tregon:

“Në vendin ku po qëndronte Resulullahu, (a.s.), kaloi një gomar me një shenjë në fytyrë. Resulullahu që e shikoi atë, tha:

“A nuk e keni dëgjuar se unë i kam mallkuar njerëzit që i gjuajnë kafshët në fytyrë ose që lënë shenjë në fytyrën e kafshëve?”

Pejgamberi (a.s.) e kishte ndaluar goditjen në fytyrë të kafshës, djegien për t'i lënë shenjë.” (Ebu Davud, Xhihad, 52)

TË QENËT I MËSHIRSHËM ME TË GJITHA GJALLESAT

Abdullah ibn Mesud (r.a.), tregon:

“Gjendeshim së bashku me Resulullahun në një udhëtim. I Dërguari i Allahut u largua për të marrë abdest. Në atë moment ne shikuam një zog me të vegjlit e tij dhe i morëm zogjtë e vegjël. Zogu mëmë sillej rreth kokave tona për t'i shpëtuar të vegjlit e vet. Në atë moment u kthye Resulullahu dhe na tha:

“Kush i mori të vegjlit dhe e zemëroi zogun? Jepni atij zogjtë e vet!”

Një herë tjetër Resulullahu shikoi folenë e milingonës që e kishim djegur dhe na pyeti:

- Kush e bëri këtë?

- Ne e bëmë.” - iu përgjigjëm.

- Dijeni mirë se vetëm Ai që ka krijuar zjarrin mund të ndëshkojë me zjarr!.. (Ebu Davudi Xhihad, 112)

NGUSHËLLIMI I RESULLAHUT

Kurre ibn Ijas (r.a.), tregon:

Kur Resulullahu ulej diku, sahabët e rrethonin





nga të gjitha anët. Njëri nga këta sahabë merrte me vete edhe djalin e vet të vogël. Ky i fundit e dëgjonte gjithmonë Resulullahun. Një ditë ky fëmijë vdiq. Babai i tij nuk shkoi më në mbledhjet që bënte i Dërguari i Allahut, sepse kishte frikë se mos i kujtohej i biri dhe i shqetësonte të tjerët. Kur e vuri re mungesën e tij, Resulullahu i pyeti sahabët:

-Pse nuk e shikoj në mesin tuaj filan njeri?

- O i Dërguar, atij i ka vdekur djali të cilin e merrte me vete gjithmonë.

Resulullahu u takua me atë njeri dhe e pyeti për të birin. Kur i tregoi që i biri i kishte vdekur, Resulullahu i përcolli ngushëllimet e veta dhe pastaj i tha:

- Më thuaj! .. A do të doje që djali yt, që të ka vdekur, të qëndronte gjatë gjithë jetës pranë teje apo do të doje që nesër kur të futesh nga cilado derë e xhenetit të gjesh djalin tënd që të hap derën dhe të thotë: 'Urdhëro brenda, i dashur baba!'

Sahabi të cilit i kishte vdekur djali, i tha:

- O i Dërguari i Allahut! Sigurisht që do të dëshiroja që ai të vraponte për të më hapur derën e xhenetit.

Pas kësaj përgjigjeje, Resulullahu i tha:

- Atëherë do të realizohet dëshira jote!.. (Nesai, Xhenaiz, 120)

VUAJTJE SA PËR DY NJERËZ

Abdullah ibn Mesud (r.a.), ka thënë:

"Unë mbërrita pranë Resulullahut, teksa Ai po digjej nga ethet e sëmundjes që e kishte zënë. E preka trupin e tij me dorë dhe i thashë:

- O i Dërguari i Allahut!.. Ti po vuan shumë nga kjo sëmundje!

-Po, unë vuaj dyfishin e vuajtjes që mund të durojë secili nga ju.

- Kjo me siguri bën që të fitosh dyfishin e seapeve.

-Po, ashtu është!.. Allahu ia fal gjynahet një myslimani kur i ngulet një gjemb në këmbë ose kur i ndodh diçka më e rëndë. Gjynahet e atij myslimani bien si gjethet e pemës. (Buhari, Merda, 3)

KJO ËSHTË VESHJA!

Ebu Burde el- Eshari tregon:

Aishja (r.a.) na tregoi një veshje të grisur dhe të arnuar në shumë vende dhe na tha:

- Betohem në Allah se Resulullahu ka dhënë shpirt brenda kësaj veshjeje. (Buhari, Humus, 5)

UNË JAM KUJDESTARI I BESIMTARËVE

Ebu Hurejre (r.a.), tregon:

Kur të Dërguarit të Allahut i sillnin xhenazen e një njeriu që kishte vdekur duke lënë pas tij borxhe, ai thoshte:

- A ka lënë ndonjë gjë me të cilën mund të paguajë borxhet?

Nëse kishte lënë pasuri të mjaftueshme për të paguar borxhet, i falte namazin e xhenazes. Në rastet kur nuk kishte lënë një pasuri të tillë, Resulullahu u thoshte myslimanëve:

- Falni namazin e xhenazes të shokut tuaj!

Kur u bënë çlirime dhe besimtarët u lehtësuan nga ana ekonomike, Resulullahu (a.s.), filloi të thoshte:

"Unë jam i pari i besimtarëve, prandaj është detyra ime të paguaj borxhet e besimtarit që ka vdekur; kurse mallrat që ai ka lënë u takojnë trashëgimtarëve të tij." (Buhari, Kefalet, 3)

DUKE PËRCJELLË UDHËTARIN

Abdullah ibn Omer (r.a.), tregon:

Kur përshëndetej me një njeri, që do të nisej për udhëtim, Resulullahu i mbante dorën me dashuri dhe nuk ia lëshonte atë derisa ai largohej. Ndërkohë bënte këtë dua:

"Qofsh nën kujdesin e Zotit, në mënyrë që të ruash fenë tënde, të dorëzosh porositë dhe të punosh për të mirë." (Tirmidhi, Deavat, 43)

TURPI, MODESTIA

Ebu Said el-Hudri (r.a.), thotë:

"Resulullahu salallahu, alejhi ve selem, ishte më"



i turpshëm se një vajzë që ka hyrë në moshën e mbulesës. Kur shikonte diçka që nuk i pëlqente, ne e kuptonim sapo shikonim fytyrën e Tij.” (Buhari, Menakib, 23)

SHTRIRJA PËR TË FJETUR

Bera bin Azib (r.a.), transmeton:

Më ka këshilluar Resulullahu, (a.s.):

“Kur dëshiron të shtrihesh, merr abdest, pastaj shtrihu në krah të djathtë dhe bëj këtë dua:

‘O Zoti im, unë ta dorëzova Ty shpirtin tim. Ty ta kam dorëzuar çështjen time dhe fytyrën time e ktheva kah Ti. Tek Ti strehova shpinën time. S’ka shpëtim



dhe as strehim përveçse tek Ti; (unë) kam besuar në librin Tënd, të cilin e ke zbritur dhe kam besuar në lajmëtarin të cilin e dërgove.”

Pastaj Resulullahu e vazhdoi kështu fjalën e Tij:

“Nëse vdes atë natë, vdes me besim; nëse nuk vdes dhe jeton, atëherë fiton sevape të mëdha. Vetëm duhet që fjalët e kësaj dua je të jenë fjalët e fundit që thua atë natë.” (Buhari, Vuðu, 75)

NJË NGA DUATË

Zejd ibn Erkam (r.a.), tregon:

Resulullahu, (a.s.), bënte këtë dua:

“O Allahu im! Mbështetem tek Ti që të më ruash

nga pamundësia ime, dembelizmi, frika, koprracia, rënia në duar të huaja kur të plakem dhe nga dënimi i varrit. Allahu im! Bëj që egoja ime të fitojë ndjenjën e modestisë dhe të mos dalë kundër Teje. Ruaje atë nga mëkatet, sepse atë nuk e mbron kush tjetër përveç Teje. Ti je Zoti i egos sime. O Allahu im! Më ruaj mua nga dituria e padobishme, zemra që nuk frikësohet, nga egoja që nuk di të ngopet dhe nga dua ja që nuk pranohet.” (Muslim, Dhikr, 73; Nesai, Istiadhe, 13, 65)

AI NUK GODISTE ASKËND

Aishe (r.a.), tregon:

“Përveç rastit kur ishte në luftë, Resulullahu, (a.s.), nuk ka goditur askënd, asnjë grua, asnjë shërbëtor (shërbëtore).” (Muslim, Fedail, 79)

O ALLAH, MBËSHTEM TEK TI !.

Enes ibn Malik (r.a.), tregon:

“Një dua që Resulullahu, (a.s.), e bënte shpesh është kjo:

‘O Allah! Kërkoj mbështetje tek Ti në raste mërzie, shqetësimi, pamundësie, dembelizmi, koprracie, frike, borxhesh të shumta dhe kalimi në drejtim i mizorëve!..” (Buhari, Deavat, 36)

NGA MORALI I TIJ I LARTË

Abdullah ibn Ebi Evfa (r.a.), ka treguar:

“Resulullahu, (a.s.), bënte shumë adhurim dhe nuk fliste kot. Ai e falte gjatë namazin, hutben e mbante të shkurtër. Ecte bashkë me njerëzit në nevojë dhe të varfrit, nuk bënte sikur nuk i shikonte nevojat e tyre.” (Nesai, Xhuma, 31; Darimi, Mukaddime, 13)

DOBITË E PIRJES SË UJIT ME TRI GLLËNJKA

Enes ibn Malik (r.a.), ka thënë:

“Resulullahu, (a.s.), e pinte ujin duke u ndalur tri herë dhe në lidhje me këtë gjë ka thënë:

“Pirja e ujit me tri gllënjka e mashtron njeriun dhe është më e dobishme për stomakun dhe për shëndetin.” (Muslim, Eshribe, 123)



Urtësi dhe Mprehtësi



Osman Nuri Topbash

E KEQJA E DËMTON TË ZOTIN

*Një mysliman nuk thyen zemra, nuk rrënon shpirta dhe nuk harron kurrë se shpirti është vend shikimi hyjnor.
Përkundrazi, e bën zemrën e tij vendstrehim, ku gjejnë paqe dhe qetësi zemrat e lënduara
dhe shpirtat e lodhur.*

Sheh Sadi Shirazi, në veprën e tij "Bostani", që përmban shumë tregime dhe fjalë të urta, tregon:

"Na ishte një përgjegjës shumë tiran dhe arrogant. Prej frikës së tij, edhe luani bëhej si luaneshë.

Një ditë, ky përgjegjës ra në një pus shumë të thellë dhe të ftohtë. Me të rënë aty, filloi të klithte me të madhe prej frikës dhe hallit në të cilin gjendej:

"A ka njeri aty? Ju lutem më shpëtoni, kam rënë keq? A s'ka njeri të më shpëtojë?" Vazhdoi të rënkonte dhe të përgjerohej në këtë mënyrë gjithë natën deri në sabah. Mirëpo, zërit të tij askush nuk ia vuri veshin, sepse të gjithë ata që e dëgjonin tregoheshin indiferentë për shkak të këqijave që kishte bërë.

Pasi kaloi një ditë e tërë, në mëngjesin e ditës tjetër, një person që e njihte po kalonte pranë pusit, dëgjoi rënkimet dhe përgjërimet e tij dhe u afrua me kuresh-tje te gryka e pusit. Sapo e pa fytyrën e përgjegjësit që ishte i famshëm për tiraninë e tij, e njohu menjëherë. Me një lëvizje të shpejtë, mori një gurë nga toka dhe e goditi përgjegjësën duke e plagosur në kokë. Ndërkohë i tha këto fjalë:

"Si je? Deri më sot a ke shkuar në ndihmë të dikujt, që tani po kërkon ndihmë? Gjithmonë ke mbjellë farën e çnjerëzisë dhe nuk ke pasur kurrë mëshirë dhe dashuri. Ja pra, tani po mbledh frytet e hidhura të padrejtësisë të tua. Kush do ta shërojë shpirtin tënd të plagosur? A mendoje ndonjëherë për shpirtat e lënduar? Ti, a u bërë ndonjëherë diell për zemrat e lagura prej shiut të hidhërimit dhe të ngrira prej të ftohtit, që tani po pret mëshirë? Jo! Përkundrazi ti gjithmonë ke hapur gropa në rrugën e lumturisë dhe qetësisë sonë. Dhe tani ke përfunduar në gropën që ke hapur vetë!"

Ja pra, ky është fundi i hidhur dhe vendi që ka në sytë e njerëzve ai që mendon keq për njerëzit, që lëndon shpirtin e robërve të mirë të Allahut Teala dhe

që nuk nguron t'i shpojë ata me gjembat e gjuhës së tij gënjeshtare.

Sheh Sadi, këtë tregim mësimdhënës, e përfundon me këto fjalë të urta:

"Për njerëzit, pusi (gropa) hapet për dy qëllime. (Njëri me kuptimin e vërtetë të fjalës dhe tjetri me kuptim figurativ).

Njeriu me karakter të mirë, hap pus (gropë) për t'u ndihmuar të eturve të gjejnë ujë. (Ky është kuptimi i vërtetë i fjalës të hapësh pusin (gropën).) Ndërsa një njeri me karakter të keq, hap pus (gropë), me qëllim që njerëzit të bien brenda. (Ky është kuptimi figurativ i fjalës dhe nënkupton edhe kurthet që bëhen me të njëjtin qëllim.)

Mirëpo, nëse bën keq, mos prit mirë! Sado që të mundohesh, tameriksi që është një bimë pa fruta dhe rritet në shkretëtirë, nuk mund të japë fruta!

Ai që në vjeshtë mbjell elb, në verë nuk mund të korrë grurë! Nëse e njeh bimën e landrës (zekumit), mos shpreso që prej saj të hash fruta të ëmbël, sepse fruti i saj është i helmatisur."

Mevlana Xhelaleddin Rumi, duke iu drejtuar atyre që u dëshirojnë të keqen njerëzve dhe tiranëve që e përdorin fuqinë dhe pushtetin për t'u bërë padrejtësi të tjerëve, thotë:

"O tiran! Me padrejtësinë tënde, je duke hapur një gropë, por dije se atë gropë po ia hap vetes. Të urtët kanë thënë se padrejtësia e tiranëve është një gropë e errët. Kush të jetë më tiran, ai e ka gropën më të errët dhe më të frikshme."

Ndërsa drejtësia hyjnore paralajmëron për një dënim edhe më të madh. Të mjerët mos i pandeh pa ndihmës, por lexo prej Kuranit ajetin: "**Kur të vijë ndihma e Allahut...**" (en-Nasr, 1) Edhe elefant sikur të jesh dhe armiku yt t'ia mbathë prej frikës tënde, shpendët Ebabel do

vijnë dhe do të gjejnë." Pra, herët a vonë do ta marrësh dënimin për të keqen që ke bërë.

Nuk duhet harruar kurrë se njeriu është duke konsumuar një kapital jetësor, i cili mund të mbarojë nga çasti në çast si fija e perit që zhdërvillet prej bobinës. Ndërsa në Ditën e Kiametit, do të japë llogari një më një për të mirën dhe të keqen më të vogël që ka bërë gjatë gjithë jetës së kësaj bote.

Për këtë arsye, një mysliman nuk thyen zemra, nuk rrënon shpirta dhe nuk harron kurrë se shpirti është vendshikimi hyjnor. Përkundrazi, e bën zemrën e tij vendstrehim ku gjejnë paqe dhe qetësi zemrat e lënduara dhe shpirtat e lodhur. Ai e di shumë mirë se:

"Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij." (Fussilet, 46)

"Nëse bëni mirësi, e keni bërë për veten tuaj. E, nëse bëni keq, ia keni bërë po vetes..." (Isra, 7)

Historia është dëshmitare se ai që gjatë gjithë jetës ka mbjellë erë, si përfundim, gjithmonë ka korrur furtunë. Çfarë ka hedhur në pjatë, ajo i ka ardhur në lugë. Njerëzve të tillë, që për të jetuar të qetë, prishin qetësinë e çdokujt tjetër përveç të vetës, qejfet dhe pasionet e përkohshme të kësaj bote nuk kanë për t'u zgjatur shumë. Jeta luksoze e padrejtë e njerëzve si Faraoni dhe Nemrudi, nuk ka zgjatur më shumë se deri në varrin e tyre!..

Në lidhje me faktin se si do të mbijnë në botën tjetër farat e zullumit, që zullumqari ka hedhur në këtë botë, e cila është edhe ara e botës tjetër, Mevlana i nderuar shprehet:

"Nëse prej dorës tënde është lënduar një i pafajshëm dhe i është bërë keq, ajo e keqe bëhet një pemë në Xhehenem dhe prej saj del fryti i zekumit (landrës). Nëse, kur të ka kapluar zemërimi ke thyer zemra dhe ke hedhur zjarr në shpirta, ai zjarr do ta ndezë zjarrin e Xhehenemit.

Nëse zjarri i zemërimit tënd ka djegur njerëz në këtë botë, në botën tjetër zjarri i Xhehenemit që buron prej tij, do të të djegë ty. Në këtë botë, zjarri i zemërimit tënd u vërsulet njerëzve. Por në botën tjetër, zjarri i Xhehenemit që buron prej tij, përsëri do t'u vërsulet njerëzve, por kësaj here, ty.

Kur në këtë botë të kaploi zemërimi dhe me fjalët e tua si gjarpërinj dhe akrepa ke pickuar njerëzit, në botën tjetër, ato fjalë do të kthehen në gjarpërinj dhe akrepa që do të të vërsulen ty."

Për këtë arsye, të fitosh zemra, të sillesh mirë me njerëzit, t'i duash të mirën të gjithë njerëzimit dhe të zotërosh gjuhën e mëshirës, është shumë e rëndësishme.

Kur sahabët fisnikë shkonin tek Rasulullahu (a.s.) dhe i thoshin:

"O Rasulallah! Të jap besën se do të bëhem mysliman." Profeti ynë (a.s.), e pranonte këtë besë ose siç ishte, ose duke vënë disa kushte. Ndonjëherë, një nga

kushtet që vinte, ishte:

"E pranoj besën tënde, me kusht që të sillesh mirë me të gjithë dhe të gjithëve t'u duash të mirën!"

Për të arritur këtë pjekuri shpirtërore, njeriu duhet të shohë prej dritares së kësaj të vërtete, që Mevlana i nderuar e ka shprehur në këtë bejte:

*Qabja është ndërtuar nga djali i Azerit,
Halil Ibrahim, i
Ndërsa shpirti, për Allahun e Madhëruar
është vendshikimi.*

Zemra dhe shpirti kanë rëndësi të madhe në lumturinë dhe paqen e njeriut. Prandaj dhe lëndimi i tyre me ndonjë të keqe, është konsideruar si një gjynah i madh nga të gjithë të mëdhenjtë e tasavufit. Mevlana i nderuar, në lidhje me vlerën e vërtetë të shpirtit, thotë këto fjalë:

"Shpirti i plagosur, të cilit nuk i jep vlerë as sa një fije kashte, është shumë më madhështor se ç'kujton. Edhe nëse është i pavlefshëm, ti mos e shih si të pavlerë! Ai, me pavlefshmërinë e tij, është më i larti prej të lartëve. Shpirti i plagosur, është qenia ku shikon Allahu Teala. Të ndreqësh shpirtin e thyer në dyqind copa, tek Allahu është më e vlefshme se çdo lloj mirësie që mund të bësh... Hesht! Edhe sikur të kesh dyqind gjuhë për të folur, përsëri shpirtin nuk mund ta tregosh."

Profeti ynë i dashur (a.s.), i cili është poezia më e bukur e gjithësisë, zotëruesi i zemrës më të përsosur dhe më të mëshirshme, të gjithë njerëzimin e ka parë nga kjo dritare botëkuptimi. Përveç faljes së gabimeve dhe të këqijave që i janë bërë, është sjellë mirë edhe me atë të cilit ia ka parë të keqen. Ka bërë dua dhe ka dëshiruar prej Allahut udhëzimin e tij. Ashtu si guaska e detit, që i dhuron perlën që mban brenda edhe atij që e godet me gurë, edhe Profeti ynë (a.s.), duke nxjerrë perlat e mëshirës prej zemrës së tij të sedeftë, u lut për udhëzimin e atyre që e goditën me gurë në Taif. Ai nuk i mallkoi as ata që i thyen dhëmbët e tij të bekuar dhe i plagosën fytyrën në Uhud, por u lut që ata të gjenin rrugën e drejtë. Gjithashtu, na mjafton si shembull edhe fakti se ai, për të mbrojtur nderin e fesë me të cilën erdhi, nuk kërkoi që populli i Mekës të shkatërrohej nga dënimi hyjnor, por dëshiroi që çdo njëri prej tyre të nderohej me islam.

Me një fjalë, ne që kemi fatin të jemi prej umetit të Profeti tonë (a.s.), që ishte dërguar si mëshirë për botët, e kemi për detyrë të përpiqemi që t'i përgjigjemi çdo të keqeje me të mirë dhe të marrim pjesë prej gjuhës së tij të mëshirës. Ky është arti i një zemre të pjekur dhe të përsosur.

Ja Rabbi! Bëji zemrat tona vende ku të gjitha krijesat gjejnë qetësi dhe gjuhët tona, gjuhë mëshirë të cilat përcjellin në zemra dashurinë dhe mirësinë Tënde!..

Amin!..



Fatma Hale Liman

Një ditë me Profetin

Një mëngjes i ndritur po zbardh në Medinë... Bilali po këndon ezanin...

"Es-salatu hajrun mine'n-nevm..."

Një gjallëri ndihet në rrugët e Medinës...

Bilali shikon çdo mëngjes të Dërguarin e Allahut në xhami. Pejgamberi, që nuk ka fjetur pas namazit të natës, ndodhet në mesxhid. Ai shkonte në shtëpinë e cila ndodhej dy hapa larg xhamisë, vetëm për të falur sunetin e namazit të sabahut. Kur sahabët shkonin në xhami, e gjenin Atë duke pritur në vendin e Tij të zakonshëm. Hyrja në xhami dhe shikimi i fytyrës së Profetit dhe, më pas, nderi për t'u përshëndetur me Të, ishin lumturia më e madhe për çdo sahab. Kjo gjë u sillte atyre qetësi në zemër. Të shikoje Atë, do të thoshte të filloje ditën mbarë. Bilali ishte i pari

nga sahabët që e shikonte Pejgamberin e dashur në mëngjes...I pari që e përshëndeste Atë. Pasi i jepte selam Resulullahut, ai fillonte të këndonte ezanin...

"Es-salatu hajrun mine'n-nevm..."

Në çdo vakt të namazit kishte një gëzim nga ata që mbizotërojnë vetëm në festa... Ky ishte një takim i rëndësishëm me Krijuesin... Xhamia ishte vendi ku mblidheshin sahabët... Ata vinin bashkë me familjet e tyre në mesxhid... (Ky zakon vazhdon të ndiqet në Medinë).

Rrugët e Medinës ishin të mbushura me gra, fëmijë dhe burra që përshëndesnin njëri-tjetrin dhe drejtoheshin drejt xhamisë. Në zemrat e tyre kishte gëzim. Trupat e tyre ecnin, ndërsa zemrat notonin në oqeanë shpirtërore. Zemrat ishin të mbushura me



dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij...

Sa mëshirë e madhe është të fillosh ditën duke shikuar fytyrën e Resulullahut!..Të parët që hynin në xhami ishin: Ummu Ejmen me burrin e saj Zejd bin Harise dhe të birin Usame... Kjo familje ishte shumë e veçantë për Resulullahun. Ummu Ejmen ishte nga zonjat më të dashura të Profetit (a.s.)... Mbas humbjes së nënës dhe deri në kalimin nën mbrojtjen e xhaxhait të Tij Ebu Talibit, kjo grua ishte kujdesur për Të, me një dhembshuri prindërore.

Të dy vazhdonin ta donin njëri- tjetrin shumë...

Burri i saj ishte njeriu që kishte vënë përpara nënës dhe babait të vet, Profetin (a.s.). Ai e kishte mbrojtur Resulullahun në Taif me trupin e vet prej gurëve që i kishin hedhur. Më pas ky sahab do të njihet si një dëshmor në Mu'te; ai e kaloi gjithë jetën e vet duke u kujdesur që Resulullahu të mos pësonte gjë.

Biri i tyre, Usame ishte në fillimin e adoleshencës... Ai vraponte për të shkuar në xhami. Sapo e shikonin Pejgamberin (a.s.), i shkonin pranë, baba e bir... I Dërguari i Allahut lutej për ta, Ai përsëri lutet... Ka një rrugë shumë efikase për të fituar zemrën e një të riu: të lavdërosh sjelljet e tij të mira dhe të bësh dua për të kërkuar të mirën e tij... Ummu Ejmen e përhëndeste Resulullahun nga larg me një buzëqeshje. Kur e shikonte Resulullahun Ummu Ejmen, zhytej në kujtime:

"Sa shpejt kaluan vitet!" - mendon ajo. "Dje e kisha në krahë, qante me dënësë për humbjen e nënës. Vetmia e Tij më kishte djegur zemrën. Ai flinte në krahët e mi, duke menduar për humbjen e nënës së dashur. Unë isha shumë e merakosur se çfarë do të ndodhte me të ardhmen e Tij, kush do të kujdesej për Të... Tani Ai është Pejgamberi ynë, udhëzues për të gjithë ne. Tani është drejtuesi ynë... Zoti i çdo gjëje është vetëm Allahu... Kur je me Allahun nuk ke shqetësime, faleminderit Atij... A nuk jemi të gjithë të Zotit tonë?! Sa lumturi të jesh rob i Allahut!.."

Hasani dhe Husejni dilnin me vrap nga shtëpia për t'iu hedhur në krahë Resulullahut... Për këta dy vëllezër thesari më i madh i kësaj bote ishte gjyshi i tyre... Sa herë që e shikonin gjyshin, linin çdo gjë për t'iu hedhur në qafë Atij. Pejgamberi ynë i hapte krahët dhe i priste me një përqaftim të ngrohtë. Fëmijët gëzoheshin shumë. Ata vraponin para nënës

dhe babait drejt xhamisë. Për më tepër që shtëpia e tyre ishte shumë pranë xhamisë... Që prej ditës kur kishin lindur, ata nuk ishin ndarë për asnjë sekondë nga familja e tyre. Kur ishin foshnja, nëna e tyre Fatimja i merrte me vete në mesxhid dhe ata të dy flinin të qetë aty. Nganjëherë i hapnin sytë e ëmbël dhe shikonin në qetësi njerëzit që falnin namaz. Që të vegjël ata i falnin pesë vaktet e namazit së bashku me gjyshin e tyre.

Ashtu siç kishte shkuar Pejgamberi që në moshë të vogël me gjyshin e vet Abdulmuttalibin edhe në mbledhje, edhe Hasani me Hysejnin që të vegjël kishin qëndruar gjithmonë pranë gjyshit të tyre. Ata ishin dëshmitarë të çdo gjendjeje dhe situatë që kalonte gjyshi i tyre. Ata janë brumosur me edukatën që u ka dhënë gjyshi i tyre. (Të gjithë psikologët janë të mendimit se formimi i karakterit të një fëmije zgjat deri në moshën gjashtëvjeçare.) Kur Pejgamberi (a.s.), la këtë botë, Hz. Hasani ishte shtatë vjeç, kurse vëllai i tij Hysejni ishte gjashtë vjeç. Këta dy vëllezër janë edukuar nga njerëz shumë të lartë, në fillim nga Pejgamberi i nderuar (a.s.) dhe më pas nga Hz. Aliu (r.a.)...

Hz. Aliu, trimi i trimave ishte njeriu që kishte pasur fatin e madh për të qëndruar më afër Pejgamberit (a.s.), se çdo sahab tjetër. Ai ka qenë i bekuar me këtë gjë. Hz. Aliu kishte pseudonimin: "dera e diturisë". Heroi i pothuajse të gjithë luftërave në të cilat ka marrë pjesë, ai ishte shembulli i diturisë dhe guximit...

Njeriu i tretë i familjes së tyre, Hz. Fatimja... Bija e Pejgamberit të fundit... Nëna me fat e dy fëmijëve: Hz. Hasanit dhe Hz. Hysejnit... Bashkëshortja e një njeriu të lartë...

Askush nuk është lutur për nipat e Tij siç bënte Pejgamberi (a.s.), për nipat e vet. Ai gjithmonë i kërkonte Allahut që t'i rriste në rrugë të drejtë... Fëmijët duhet ta kenë ndjerë këtë gjë, sepse ishin shumë të dhënë pas gjyshit të tyre... Këta dy fëmijë ndodheshin pranë Pejgamberit edhe kur Ai takohej me Xhebrailin (a.s.). Sapo i shikonte fëmijët, Xhebraili bënte dua për ta...

Fëmijët që rriten me dashuri mësojnë të duan, fëmijët që rriten me tolerancë mësojnë të mos kërkojnë gabimet e njerëzve, fëmijët që rriten me përpulje janë



të dhembshur me çdokënd... Fëmijët që rriten duke mësuar të kenë nën kontroll egon e tyre, a mund të mendojnë vetëm për veten e tyre?! Duke u nisur nga edukata që kishin marrë, Hasani dhe Hysejini ishin gati të bënin çdo gjë për të mbajtur të bashkuar dhe në paqe bashkësinë myslimane.

Në xhami hynë Hz. Aliu dhe Hz. Fatimja... Fatimja (r.a.), është një vajzë që e do pa masë babain e vet. Në një vend ku gjendej babai i saj, ajo nuk arrinte të shikonte asgjë tjetër... Një shembull i përkryer për çdo grua besimtare...

Begatia më e madhe që kishte kjo familje ishte dituria. Pejgamberi nuk e ka lejuar vajzën e vet të dashur të merrte shërbëtore në shtëpi, as të ndërronte shaminë që mbante me një shami të stolisur. Ai e këshillonte gjithmonë Fatmën të qëndronte larg kënaqësive të kësaj bote dhe të përkushtohej ndaj familjes së vet.

Fëmijët e praktikuan gjatë gjithë jetës së tyre edukatën që morën në familje. Kjo familje edhe kur kishin agjëruar, ua jepte iftarin e vet njerëzve të varfër e jetimë. Ata do të jenë një shembull për të gjithë besimtarët me zemrat e tyre të mëdha. Hz. Aliu, tekasa po falte namaz, nga përkushtimi i fuqishëm që kishte ndaj asaj që po bënte, nuk e ndjeu fare shigjetën që iu ngul në trup... Historia e atij që nuk e vrau njeriun që i pështyu në fytyrë, nga frika se mos kjo do të ishte një vrasje e bërë për hatër të egos, do të përcillet nga brezi në brez...

Kjo familje është e mençur, trime, e ditur, guximtare dhe e veçantë. Kjo duhet të jetë arsyeja që Pejgamberi (a.s.), ka urdhëruar të duhet dhe të respektohet familja e Tij. Kjo gjë, në të njëjtën kohë është edhe një urdhër i Allahut. Në ajetin 23 të sures Shura thuhet:

"Për këtë nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi tjetër prej jush, përveç respektit (për mua) për hir të farefisnisë që (kemi)."

Pejgamberi (a.s.) dhe familja e Tij janë një shembull që duhet ndjekur nga të gjithë ne.. Ekzistenca e tyre është një bekim i madh për ne!..

Banorët e Medinës sistemoheshin në xhami. Shtëpitë dhe rrugët mbesnin të shkreta. Xhamia mbushej plot. Të gjithë rrinin në qetësi dhe prisnin fillimin e namazit. Pejgamberi ynë i nderuar ngrihej në këmbë

dhe fillonte faljen e namazit. Në rreshtat e drejtuara nga Resulullahu merrnin pjesë edhe engjëjt...

Falja e namazit çdo mëngjes përkrah Resulullahut ishte një dhuratë shumë e madhe për njerëzit që dyndeshin drejt xhamisë. Namazet e falura së bashku, ngjitur me njëri-tjetrin ishin një kënaqësi e madhe shpirtërore, që u jepte forcë sahabëve për të jetuar sipas rregullave të fesë islame dhe u jepte guxim në luftë.

Aftësia që kishte një sahab për t'u përballur me njëzet jobesimtarë në luftën e Bedrit, është e fshehur në namazet e falura sup më sup me Resulullahun dhe në vlerat e mëdha shpirtërore që fitonin nga kjo.

Ah, ajo xhami dhe mësimet shpirtërore që jepeshin atje! Pas namazit, sahabët prisnin Pejgamberin për t'i komentuar ëndrrat e tyre dhe për të dëgjuar se cilat ishin mësimet që do t'u jepte Ai atë ditë. Të gjithë prisnin për të dëgjuar fjalët e Pejgamberit dhe për të përfitur prej Tij...

Pas namazit, secili shkonte për të ngrënë mëngjesin dhe për të vazhduar aktivitetin ditor. Dikush shkonte në Pazar e dikush tjetër në kopshtet e hurmave. Gratë fillonin të bënin punët e shtëpisë dhe të merreshin me edukimin e fëmijëve. Një veçori tjetër e grave të Profetit është se sa herë që ishin pranë Tij, përqipeshin të merrnin mësim nga Profeti ynë i nderuar.

Dita e filluar me namaz vazhdonte rrjedhën e saj, ndërkohë çdo punë e rëndësishme zgjidhej në xhami pranë Resulullahut; ishte Ai që gjykonte çdo gjë. Profeti i gjykonte të gjitha çështjet familjare, shoqërore, materiale dhe tregtare nën dritën e Kuranit. Nuk ishin vetëm këto çështjet që zgjidheshin nga i Dërguari i Allahut. Ai gjithashtu zgjidhte problemet që kishin lidhje me pazarin e Medinës apo me marrëdhëniet me fqinjët çifutë. Çdo problem që shqetësonte një individ ose një pjesë të shoqërisë përcillej në xhami për t'u zgjidhur nga Resulullahu.

Edukimi, drejtësia dhe mëshira nuk mbaronin kurrë në Medinë... Ata ishin të kujdesshëm gjithmonë... Nuk lejohet që të gënjeshtrohet fëmijën që do t'i japësh hurma, i këshillonte i Dërguari:

"Nëse nuk ke hurma dhe thërret: 'Hajde se do të të jap hurma!' ta dish se kjo është një gënjeshtër e jotja."
(Ebu Davud, Edeb, 80/ 4991)



Sa fjalë e madhe është kjo dhe sa punë kërkon që ta zbatojmë në jetë. Pejgamberi ynë çdo çast mendonte për njerëzit që e ndiqnin dhe shqetësohej për çdo problem të tyrin.

Banorët e Medines nuk linin pas dore as vizitat tek të afërmit, tek njerëzit e sëmurë apo tek njerëzit e moshuar... Çfarë morali i lartë ishte ky. Edhe fqinjët çifutë të Pejgamberit ishin të kënaqur nga sjelljet e Tij. Kur ata kishin nevojë, Pejgamberi i ndihmonte me sa kishte mundësi.

Edhe vetë ata e dinin shumë mirë se Ai ishte pejgamber i vërtetë... Çifutët kontrollonin çdo lëvizje të Pejgamberit tonë në çdo çast, sepse kërkonin të gjenin ndonjë gabim të Tijin... Kjo sigurisht që ishte e pamundur... Edhe duke pasur besimin se Pejgamberi ynë dëshmonte të vërtetën, ata nuk arrinin dot të mposhtnin krenarinë e tyre dhe ta pranonin haptas këtë gjë. Kjo do të thotë se njohja e së vërtetës jo gjithmonë sjell besimin... Disa njerëz zgjedhin mohimin. Në fund të fundit besimi është çështje udhëzimi...

Në çdo fillim të ri, në çdo punë të re ishte Pejgamberi (a.s.)... Atij i tregonin çdo gjë... Ai e dinte kur vdiste një njeri e kur lindte një tjetër... Të gjithë i kërkonin dua Resulullahut... Njerëzit që shkonin për t'i bërë pyetje ishin të shumtë:

-O i Dërguar, më thuaj të bëj diçka që të futem në xhenet!

Pyetjet e tilla nuk mungonin asnjëherë. Resulullahu i jepte përgjigje secilit sipas mënyrës, që bashkëbiseduesi ta kuptonte dhe sipas karakterit të personit... Dikujt i përgjigjej:

- Mos u zemëro!..

Dikujt tjetër:

- Kujdesu për nënën e babain, për vëllain!

Kurse dikujt tjetër:

- Bëj dua të mira për familjen tënde, mos mallko kënd!..

Pejgamberi (a.s.), ishte gjithmonë i gatshëm për t'i dhënë përgjigje çdo pyetjeje që i bënin gratë e Tij dhe vajza Fatimja... Edhe ato ishin nxënëse të Tij...

Shpallja vazhdonte të zbrishte, Pejgamberi ynë fliste me Xhebrailin (a.s.)... Në Medinën e ndritur dita fillon me faljen e namazit të sabahut dhe përfundon me namazin e jacisë. Të nesërmen përsëri do të jetë një ditë e mbushur me aktivitete, ajete të rinj do të zbresin, do të fitohen njohuri të reja. Ajetet e reja do të përfshihen në jetë, do të praktikohen menjëherë... Do të bëhet niset për të bërë gjëra të mira për hatër të Allahut... Besimtarët nuk do të reshtin kurrë së përpjekuri, besimtari nuk duhet të jetë kurrë dembel. Do të bëhen përpjekje edhe për këtë botë edhe për botën e përtejme...


Sot, edhe ne jemi me fat... Pejgamberi (a.s.), nuk ndodhet pranë nesh fizikisht, por veprat e Tij dhe mënyra e Tij e jetesës është gjithmonë e gjallë tek ne... Shpirti dhe morali i Tij janë pranë nesh... Sa bukur e ka thënë Junus Emreja:

"Kafshët vdesin, dashuria nuk vdes.

Lëkura vdes, shpirti kurrë nuk vdes."

Të ndjej Resulullah, Ti je në mesin tonë... Bekimi dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Ty, familjen Tënde dhe shokët e Tu!..

Amin!..





SA E DUAM

Resulullahun?..

Kybra Çoban

“Ne të duam Ty, o i Dërguar!”

Sa të sinqertë jemi kur themi këto fjalë? A është zemra që flet apo vetëm gjuha? Diçka që është e vërtetë kuptohet nga veprimet që ne bëjmë. A e shfaqin veprimet tona këtë gjë? Sikur ta donim më të vërtetë a nuk do të mundoheshim pak më shumë t'i ngjasonim Atij? A nuk do ta ndjenim aromën e tij prej trëndafili?

“Ne të duam Ty, o i Dërguar!”

Kur do dikë e kujton atë në mënyrën më të bukur. Sikur me të vërtetë ta donim, do t'u flisnim miqve tanë dhe familjes sonë vetëm për Të... Ajo çfarë është në zemër pasqyrohet në gjuhë... Ku është parë që nga një kopsht me trëndafila të vijë një aromë e keqe? A ka gjë më të bukur sesa të flasim për Të gjatë gjithë kohës? Sa e njohin të rinjtë dhe fëmijët Resulullahun?! *“Në Ditën e Gjykimit më pranë meje do të ndodhen njerëzit që më kanë kujtuar më shpesh.”* (Tirmidhi, Vitri, 21)

Sa herë në ditë na kujtohet Resulullahu, salallahu alejhi ve selem? Sa herë e përkujtojmë me zemër të Dërguarin e Allahut?..

“Ne të duam Ty, o i Dërguar!”

“Njeriu i ngjan njeriut të dashur.” A e marrim shembull ne Resulullahun? A jetojmë me synetin e Tij? Njerëzimi lartësohet kur merr shembull të Dërguarin e Allahut, sepse Ai është shembulli më i përsosur.

Resulullahu na ka thënë:

“Unë po ju lë diçka që, nëse mbaheni fort pas tyre, nuk do të devijoni kurrë nga rruga e drejtë, këto janë: libri i Allahut dhe syneti i pejgamberit...” (Hakim, Mustedrek, I, 93)

Sikur të kuptonim vlerën e këtyre dhuratave, do të ishim të fituar në këtë botë dhe në ahiret. Në cilën prej veprimeve tona i ngjajmë Resullahu? Në të ngrënë, në të pirë, në sjelljen më njerëzit, në mënyrën e qëndrimit apo në mënyrën e adhurimit?

Ai lidhte gurë në bark dhe qëndronte tri ditë pa ngrënë, kurse në sofrat tona ka lloje të shumta ushqimesh në tre vaktet e ditës. Ai agjëronte të paktën dy herë në javë, kurse ne kujtohemi për agjërimin vetëm gjatë muajit të Ramazanit.

Edhe pse të gjitha mëkatet e Tij, mëkatet e së shkuarës dhe të së ardhmes ishin të falura; Ai falte namaz gjithë natën... Këmbët e Tij ishin të fryra nga qëndrimi i gjatë në këmbë (gjatë namazit të natës), kurse ne i kemi sytë të fryrë nga gjumi i tepërt.



Resulullahu (a.s.) ka thënë:

"Xheneti është nën këmbët e nënës." (Nesai, Xhihad, 6)

Si sillemi ne me nënat tona? Kë marrim si shembull, teksa flasim me fëmijët, bashkëshortin tonë?

Pejgamberi (a.s.), na ka këshilluar kështu:

"Suneti i trupit është që të vishet sa më mirë."

A e ndjekim këtë këshillë, teksa zgjedhim rrobat tona?

Gjëja më e papëlqyer e Tij ishte era e gojës dhe për këtë i pastronte dhëmbët me misvak shumë shpesh; po ne, sa jemi të kujdesshëm në këtë pikë? A i japim rëndësi pastërtisë së gojës?

Sa ngjason sjellja jonë me njerëzit me mënyrën e Tij të sjelljes? Ai ishte një njeri aq i ndjeshëm, sa e ngushëllonte fëmijën që ishte i mërzitur nga vdekja e një zogu. Vallë, cila nga sjelljet tona na e kujton Resulullahun? A nuk shikohen tek njeriu i dashuruar ngjashmëri me njeriun që do? Nëse nuk ndodh kështu, atëherë dashuria është vetëm një pohim i thatë dhe pa vlerë.

"Ne të duam Ty, o i Dërguar!"

Ai na ka thënë:

"Njeriu është me njeriun e dashur." (Buhari, Edeb, 96)

Sa minuta në ditë e ndjemë pranë vetes Resulullahun? E ndjemë praninë e Tij teksa falim namazin me nxitim, kur jemi të ulur para televizionit apo kur jemi duke dëgjuar muzikë?

Sa herë mendojmë se si do të sillej Pejgamberi në një situatë që na del përpara? Ai nuk i mallkoi as njerëzit që e gjuanin me gurë. Cili nga ne mund të jetë kaq i mëshirshëm para një veprimi të padrejtë që na bëhet? Sa herë e kemi kontrolluar zemërimin tonë, vetëm pse Pejgamberi ynë i nderuar ka bërë ashtu?..

"Ne të duam Ty, o i Dërguar!"

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Më i miri nga ju është ai që mëson Kuran dhe ua mëson edhe të tjerëve." (Buhari, Fezailul Kuran, 21)

Sa mundohemi ne për të mësuar Kuran? Sa ajete në ditë lexojmë dhe sa prej tyre i praktikojmë në jetën tonë?

"Ne të duam Ty, o i Dërguar!"

Përpjekja më e madhe e Resulullahut ishte të fitonte dashurinë e Allahut në çdo veprim që bënte. Përpjekja jonë duhet të jetë e njëjtë me përpjekjen e Tij.

Ne e kemi detyrim të urdhërojmë për të mirë dhe të ndalojmë të keqen. Sa e zbatojmë këtë gjë? A i këshillojmë ne njerëzit të largohen nga rruga e gabuar dhe të kthehen

në rrugë të drejtë?

I Dërguari nga Resulullahu për të shpjeguar rrugën e drejtë, Umejr (r.a.), kishte thënë:

- O Resulullah, nuk ka mbetur asnjë shtëpi në Medinë, në të cilën nuk është folur për Islam!..

Po ne sa flasim për Islam, a është feja jonë temë diskutimi me miqtë dhe të afërmit tonë?

"Ne të duam Ty, o i Dërguar!"

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Muslimani është njeriu, nga dora dhe gjuha e të cilit nuk dëmtohet askush; kurse besimtari është ai njeri të cilit i besojnë të gjithë njerëzit në lidhje me jetën dhe me pasurinë e tyre." (Buhari, Iman, 4,5)

Edhe armiqtë e quanin "Muhamedi i besueshëm" dhe i linin atij amanetet e veta. Sa i ruajmë ne porositë që na jepen? Le të mos përmendim armiqtë, por nga miqtë; sa prej tyre kanë besim tek ne?

Resulullahu edhe në krijesën më të ulët kërkonte të gjente diçka të mirë. Po ne, a nuk kërkojmë të meta edhe tek krijesa më e bukur?!

"Ne të duam Ty, o i Dërguar!"

Një zë brenda meje më thotë se kjo fjali nuk është tjetër veçse një gënjeshtër e madhe. A e duam Resulullahun si sahabët, që pa hezitim pranonin: "Nëna dhe babai im të qofshin kurban, o Resulullah"; apo e duam si Bilali (r.a.), që pas vdekjes së Tij nga hidhërimi nuk këndoi më ezanin? Si e duam ne Resulullahun, salallahu alejhi ve selem; si Hazreti Ebu Bekri, si Hazreti Omer, si Hazreti Othman apo si Hazreti Ali?.. Dashuria dhe nënshtrimi i cilit prej tyre gjendet dhe në zemrën tonë? Cila pjesë e ditës sonë i ngjan ditës të Resulullahut, çfarë bëjmë ne për këtë gjë?

"Ne të duam Ty, o i Dërguar!"

Çfarë dashurie është kjo? Çdo zjarr lë një shenjë. Kur digjet druri, del tymi, po zjarri i dashurisë sonë për Pejgamberin si bëhet i dukshëm? Ne duhet të vrapojmë në kërkim të dashurisë për Të, ashtu siç vrapon njeriu që ka ngrënë diçka të kripur në kërkim të ujit...

"Dashuria mes dy zemrave është si një lidhje elektrike. Rryma që kalon në të është treguesi i forcës së kësaj dashurie."

O Allah, bëj që dashuria ndaj të Dërguarit Tënd të rritet aq shumë, sa ta duam Atë më shumë se veten! Bëj që çdo moment i jetës sonë të jetë i mbushur me të! Amin!



Seber Ajdën

JEMI ME TY

O i Dërquari i Allahut

Paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi Ty...

O Resulullah! Ne jemi jetimët që nuk patëm fatin të jetonim në kohën Tënde dhe të rriteshim me Ty!.. Ne jemi njerëzit që mudo-hemi të të mbajmë gjallë në zemrat tona dhe të jetojmë gjithmonë me Ty...

"Kush më viziton mua pas vdekjes, është sikur të më kishte vizituar kur isha gjallë..." (Darekutni, Sunen, II, 278)... Ne e vizitojmë shtëpinë Tënde me shpresën për të përfituar nga ky bekim...

Nganjëherë na duket sikur po falim namazin pranë Teje dhe sikur marrim pjesë në bisedat e Tua me Hz. Ebu Bekrin dhe Hz. Omerin...

Të shikojmë me sytë e zemrës Ty që je: babai i fëmijëve jetim, ndihmëtar i lutjeve dhe shok i njerëzve të vetmuar. Na mahnit dua ja jote: *"O Zoti im! Bëj që të jetoj si një njeri i varfër; bëj që të vdes si një njeri i varfër; më ringjall mua së bashku me njerëzit e varfër!"* (Tirmidhiu, Zuhd, 37)

Sa shumë e gëzove të riun Xhabir (r.a.), që kërkoi ndihmë prej Teje... Ti e bleve devenë e Tij për t'ia bërë dhuratë më pas!..

Një ditë, teksa po ecje mes mallrave të fituara në luftë së bashku me politeistin Safvan bin Umeje, shikove se ai po shihte i mrekulluar plaçkat e luftës dhe i the:

- Kjo luginë dhe çfarë ka brenda është e jotja!

Safvani u habit dhe u gëzua në të njëjtën kohë:

- Zemra e askujt tjetër, përveçse e një Pejgamberi mund të jetë kaq bujare!..

Pas këtyre fjalëve, ai përqafoi Islamin dhe i tha fisit të vet:

- O fisi im, bëhuni myslimanë; Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, bën dhurata të tilla që nuk do të frikësoheni më kurrë nga

*Ne jemi
njerëzit
që mudo-hemi
të të mbajmë
gjallë
në zemrat tona
dhe të jetojmë
gjithmonë
me Ty...*





varfëria!..

O Resulullah! Ti ishe më i dashuri i Allahut dhe i gjithë njerëzve. Ti kujdeseshe për njerëzit dhe bisedoje me ta, me qëllimin për të forcuar besimin në zemrat e tyre...

Ti në veçanti doje fëmijët dhe ua bëje të ditur atyre këtë dashuri që ndjeje, nganjëherë me fjalë e nganjëherë me vepra. O Resulullah! Kur ktheheshe nga një udhëtim, i merrje fëmijët në kafshën tënde dhe i shëtisje ata, i zbavitje . Një ditë po shkoje tek shtëpia e një sahabi që të kishte ftuar. Rrugës takove Hysejnin (r.a.), që ishte duke luajtur. Ti hape duart për ta kapur, por ai u largua. Atëherë Ti vrapove pas tij duke qeshur.

O Resulullah, Ti ishe dhe një baba i pashembullt për fëmijët e Tu! Çuditëmi se si Ti vazhdoje të shkoje tek shtëpia e Fatimes për ta ngritur në namazin e sabahut edhe kur ishte martuar... Kur ajo të vinte për vizitë, Ti ngriheshe në këmbë dhe i puthje duart.

Lumturia e tyre ishte dhe lumturia Jote, hidhërimi i tyre ishte dhe hidhërimi Yt. O Resulullah, ditën kur vdiq djali Yt Ibrahim, Ti duke e përqafuar the:

- Zemra hidhërohet, syri loton!..

Ne qajmë së bashku me Ty kur shikojmë lotët që derdhen nga sytë e Tu të bekuar.

Në luftën e Bedrit vajza Jote e madhe Zejnepi kishte dërguar gjerdanin që i kishte dhuruar nëna e saj Hatixhe (r.a.), në shkëmbim të lirimit të burrit të saj Ebul As, që kishte rënë rob. Ti ishe prekur shumë nga ky veprim dhe kishte thënë:

- Nëse e lironi Ebul As-in, a mund ta ktheni mbrapsht edhe shpërblimin që keni marrë për të?

Të qofshim kurban, o Resulullah! Lumturia jote është burim jete për ne, është dritë.

Ti ishe i butë me të gjithë dhe na këshilloje të ishim të tillë; por kur dikush i sillej padrejtësisht jetimit ose shtypte të dobëtin, Ti zemëroheshe shumë dhe nuk të ikte ky zemërim derisa drejtësia gjente vendin e saj. Një ditë Ti ke shkuar pranë Ebu Xhehli bashkë me një jetim që ankohej për padrejtësi. Ebu Xhehli, që gjithmonë e kishte sharë jetimin për ta dëbuar më vonë, kur të shikoi Ty e ktheu mallin që kishte marrë padrejtësisht. Politeistët që shikuan këtë gjë, u tallën me Ebu Xhehlin, duke i thënë:

- Çfarë ke, u frikësove nga Muhamedi?

Ebu Xhehli iu përgjigj:

- Beto hem që në të djathtë dhe në të majtë të Tij shikova dy shtiza, që për pak u sulën drejt meje.

Një herë tjetër, një grua nga një familje me emër kishte vjedhur diçka dhe njerëzit e fisit Kurejsh kishin dërguar Hz. Usame bin Zejdin (r.a.), të cilin Ti e doje shumë, që të fliste me Ty... Fytyra jote ishte skuqur nga zemërimi kur kishte dëgjuar këtë kërkesë dhe e kishte qortuar rëndë Usamen Tënd të dashur, duke i thënë:

-Ti po bën ndërmjetësim për të mos zbatuar ligjet e vendosura nga Allahu?!

Kur e kishte kuptuar se të kishte mërëzitur aq shumë Usame (r.a.), ishte penduar shumë dhe kishte thënë:

- O i Dërguari i Allahut, bëj dua që të më falet ky gabim! (Buhari, Megazi, 53; Nesai, Katus Sarik, 6, VIII, 72-74)

Ti ishe ngritur në këmbë për të thënë :

- Për këtë arsye u shkatërruan popujt para jush: Kur një njeri që vinte nga një familje e njohur ose që kishte pozitë dhe pasuri kryente vjedhje nuk dënohej; kurse njerëzit e dobët dhe të vetmuar dënoheshin menjëherë. Unë beto hem në Allahun se, edhe sikur vajza e Muhamedit, Fatimja të vidhte, do t'ia prisja dorën!" (Buhari, Enbija, 54; Muslim, Hudud, 8,9)

Kur ndërrove jetë Ti, o Resulullah, qyteti i Medines u rrënua nga hidhërimi. Të mbesësh pa Ty pas njohjes me Ty, është një nga dhimbjet më të mëdha që mund të provojë një njeri...

Hz. Fatimja, edhe pse e dinte se ishte e para nga familja që do të bashkohej me Ty, nga dhimbja i tha Hz. Aliut:

- O Ali! Si mundët të futni në dhe trupin prej trëndafilash të Resulullahut, salallahu alejhi ve selem? Si mundët ta lini në tokë trupin e Tij të bekuar dhe të ktheheni në shtëpi?

Hz. Omeri (r.a.), kishte nxjerrë shpatën nga këllefi dhe i hidhëruar kishte thënë:

- Do t'ia pres fytin atij që thotë se ka vdekur Muhamedi, salallahu alejhi ve selem!.."

Ndarja me Ty ishte shumë e vështirë... O i Dërguari i fundit, sa e vështirë është të mësohesh me mungesën Tënde...

O Resulullah!

Ti je sulltani i të gjitha krije-save!

Ti je i Dërguari i fundit i Allahut!

Ti je mëshirë për njerëzimin!

Ti je më i shtrenjti për ne!

Paqja dhe bekimi qofshin mbi TY dhe të dashurit e Tu!

Es- Salatu ve's Selamu alejke ja Resulullah!..

Es- Salatu ve's Selamu alejke ja Habiballah!..

Es- Salatu ves-selamu alejke ja Sejidel- evveline vel -ahirin... Vel - hamdu lillahi Rabbil - alemin.





Sbefika Kaja Meriç

Arki ekti i një rez të palëkundur Profeti besnik

- salallahu alejhi ve selem -

Besnik ndaj umetit, besnik ndaj shokëve, besnik ndaj bashkëshortes, besnik ndaj fëmijëve, një karakter në majën e besnikërisë... para së gjithash, një pejgamber besnik ndaj Zotit të tij; Hz. Muhamed Mustafa, salallahu alejhi ve selem...

Është vepër e një personaliteti kulmor të arrish të mos kesh as më të voglin dyshim në lidhje me të dhe të mendosh gjithmonë: "Në qoftë se e ka thënë ai, ka thënë të drejtën, në qoftë se ka thënë ai atëherë e bën patjetër."

Një personalitet i tillë që, të gjithë ata që e besuan dhe nuk e besuan, ishin të mahnitur nga serioziteti, besnikëria dhe karakteri i Tij.

Siç ndodh me të gjitha cilësitë e Tij, Profeti (a.s.), ishte shembull edhe në besnikëri.

Ai e përshkruante myslimanin si *njeri nga dora dhe gjuha e të cilit nuk dëmtohen të tjerët*. (Buhari, Iman, 4,5) Duke thënë se cilësia e hipokritit është *të japë fjalën dhe të mos e mbajë*, ka theksuar fort që besimtari duhet patjetër të jetë një njeri *i cili e mban fjalën*.

Mbatja e fjalës për një besimtar fillon me mbajtjen e fjalës ndaj Zotit të tij. Të mbajmë fjalën e dhënë në fillim, ti përgjigjemi asaj fjale që është shkaku i ardhjes sonë në këtë botë.

Atë kohë kur Zoti ynë na tha:

"A nuk jam unë Zoti juaj?"

Ne iu përgjigjëm: *"Po o Zot, Ti je Zoti ynë"*, duke dhënë kështu fjalën e jetës sonë. Edhe kauza e Profetit tonë ishte mbajtja e kësaj fjale dhe në sajë të kësaj fjale të lartësonte emrin e Allahut.

Besnikëria dhe qëndrueshmëria (sinqeriteti) janë elementë që plotësojnë njëri-tjetrin. Besnikëria pa qëndrueshmëri bart një rrezik, si braktisja në mes të rrugës e njeriut apo kauzës që i keni besuar. Duhet një nënshtrim i tillë, që të mos mendohen fare pyetjet "si?" dhe "pse?", por të mendojmë gjithmonë që: "Nëse e thua ti, e ke thënë saktë, nëse ti dëshiron ashtu, atëherë ashtu duhet të jetë!"

Besnikëria e vërtetë nuk përmban asnjë fije dyshimi.



Ky lloj nënshtrimi dhe kjo lloj besnikërie ndaj shërbimeve dhe kauzës së cilës besimtari i ka kushtuar jetën, është kushti primar. Nëse fillojmë të mendojmë pyetjen “Vallë?”, nuk mund të përparojmë në rrugën e shërbimit.

Profeti ynë dhe të gjithë pejgamberët në përputhje me pastërtinë e shpirtit të tyre, pastërtinë e zemrave dhe natyrshmërinë e tyre nuk kanë ndërjerë asnjëherë asnjë fije dyshimi në zemrat e tyre.

Ibn Abbasi (r.a.), transmeton:

Kur Profeti (a.s.), u dërgua në xhaminë Aksa natën e Miraxhit, Allahu i Lartë i mblodhi të gjithë pejgamberët atje. Xhebraili këndoi ezanin dhe ikametin. Pastaj i tha Profetit tonë:

“O Muhamed! Kalo para dhe priju këtyre në namaz!”

Kur Profeti (a.s.), e përfundoi namazin, Xhebraili lexoi ajetin:

“Pyeti të dërguarit Tanë, që i kemi nisur para teje, a mos kemi urdhëruar Ne që të adhurohen zota të tjerë, përveç të Gjithëmëshirshmit?” (Zuhruf, 45)

Xhebraili i tha: “O Muhamed! Pyeti njëherë.”

Profeti tha: “Nuk i pyes, sepse s’kam dyshim.”

Kjo është njësia. Njësia e besimit, pra ky është besimi dhe bindja. Dhe pikërisht kjo është edhe besnikëria e qëndrueshmëria.

Profeti (a.s.), sikur e qëndiste në shpirtrat e sahabëve të Tij ndjenjën e besnikërisë që zotëronte. Sepse kauza që kishte sjellë, kërkonte një nënshtrim dhe qëndrueshmëri të madhe.

Në këtë bisedë të bërë mes Zotërisë sonë dhe Habbab bin Eretit shpjegohet shumë mirë rëndësia e nënshtrimit:

Në Mekë Hz. Habbabi nuk kishte kënd që ta mbronte, prandaj idhujtari Esved bin Abdiyagus e torturonte. Habbab bin Eret tregon:

“Kemi përjetuar torturat më të rënda prej idhujtarëve. Shkuam te Profeti (a.s.). Zotëria ynë kishte vënë nën kokën e tij rrrobën e Tij të nderuar dhe po rrinte nën hijen e Qabes. I treguam për torturat e idhujtarëve dhe i thamë:

‘O i Dërguari i Allahut! Lutju Allahut për ne. Kërko ndihmë prej Allahut për ne. O i Dërguari i Allahut, nga që kemi frikë se mos ky popull na kthen nga feja jonë, a mund t’i kërkosh ndihmë Allahut për ne? A mund të lutesh për ne?’

Profetit (a.s.), i ndërroi menjëherë ngjyra e fytyrës. Me fytyrën që i ishte skuqur, u drejtua e tha:

“Pasha Allahun, kur kapej një besimtar prej atyre që ishin para jush, haqej një gropë për të, personi futej në gropë deri në gjunjë pastaj merrej një sharrë, i vendosej mbi kokë dhe ndahej më dysh dhe kjo torturë nuk e kthente atë nga feja e tij.

Ose i gërryhej mishi nga kocka me një krëhër hekuri dhe përsëri kjo torturë nuk e kthente nga feja e tij.

Kini frikë Allahun! Padyshim Allahu do t’jua mundësojë çlirim. Pasha Allahun, Ai do ta plotësojë këtë çështje. Kjo çështje do të plotësohet patjetër. Dispozita e kësaj çështjeje do të vihet në vend. Bile një njeri i hipur në kafshën e tij do të shkojë nga Sana në Hadramut dhe nuk

do të ketë frikë kënd tjetër përveç Allahut. Përveç në qoftë se ka dele e do të shqetësohet se mos ia sulmon ndonjë ujë. Por ju nxitoni!” (Buhari, Menakibul-Ensar, 29; Ebu Davud, Xhihad, 97/2649)

Pas kësaj, Profeti (a.s.), na përkëdheli shpinat dhe na bëri dua. Këto fjalë të bukura të Profetit (a.s.), që ishin shërim për shpirtrat, na i pakësuan dhimbjet.”

Fakti që Profeti (a.s.), ka dhënë përgjigje me një shebull kaq tronditës, tregon se sa të rëndësishme janë besnikëria dhe qëndrueshmëria (sinqeriteti).

Në suren Ahzab, Zoti ynë jep lajmin e mirë për shpërbllimin e sinqeritetit në besnikëri:

“Nuk ka dyshim se Allahu do t’i shpërblejë të sinqeritet për sinqeritetin e tyre e do t’i dënojë hipokritët, nëse do ose do t’u pranohet pendimin. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Ahzab. 24)

Besnikëria është një cilësi e lartë dhe pas profetësisë, është pozita më e lartë. Përfaqësuesi më i madh i njerëzve në këtë pozitë është Hz. Ebu Bekri. Ai e shpjegon kështu arsyen e besnikërisë ndaj Profetit (a.s.):

“Ai m’i hapi sytë nga e vërteta, kështu që duhet t’i qën-





droj gjithmonë besnik.”

Besnikëri ndaj Atij që është bërë shkak për udhëzimin e tij... besnikëri ndaj arsyes që e ka shpëtuar nga buza e greminës...

Sërish në suren Ahzab, besimtarët të cilët e kanë merituar lavdërimin e Allahut përshkruhen si besimtarë të cilët e kanë mbajtur fjalën e dhënë Zotit të tyre edhe sikur t’u ketë kushtuar jetën:

“Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.” (Ahzab, 23)

Besimtarët e përmendur në këtë ajet janë sahabët e nderuar, të cilët kishin marrë përsipër përgjegjësinë të vepronin së bashku me të Dërguarin e Allahut. Ata mundoheshin që në çdo luftë të merrnin pjesë bashkë me të Dërguarin e Allahut dhe kishin dhënë fjalën të luftonin derisa të bëheshin shehidë (dëshmorë). Këta ishin Othman bin Affan, Talhabin Ubejdullah, Said bin Zejd, Hamza, Musab bin Umejr dhe Enes bin Nadir. Ata iu bashkuan luftës bashkë me Profetin. Disa, si Hz. Hamza, Musab bin Umejr dhe djali i xhaxhait të Enes bin Malikut, Enes bin Nadir, ranë shehidë duke pëmbushur kështu fjalën e dhënë. Ndërsa ata që prisnin të bëheshin shehidë, si Hz. Othmani dhe Hz. Talha ranë shehidë më vonë.

Një nga shembujt më të gjallë të besnikërisë ishte dhe sahabiu Hz. Hubejb. Gjatë një sulmi, idhujtarët mekas e kishin zënë rob dhe ishin mbledhur të gjithë te koka e tij për ta vrarë. Në atë kohë idhujtarët i thanë:

-Si thua, sikur të ishte këtu tani ai pejgamberi dhe të vrisnim atë në vendin tënd, a nuk do të ishte më mirë?

Këtë propozim rrëqethës Hubejbi i dha një përgjigje të tillë, që e shënoi atë në librin e famshëm të historisë:

-Lëre vrasjen në vendin tim, por në vend që t’i hyjë një gjemb në këmbë atje në Medine, le të sakrifikohen një mijë Hubejb si unë! (Vakidi, I, 360; Ibn Sad, II, 56)

Ishte koha më e vështirë në Uhud. Në kohën më të nxehur të betejës, nga ata që ranë ishte dhe Hz. Sad bin Rebi. Fiks në çastin kur do të vdiste, i pati thënë kështu personit që i kishte sjellë selame nga Profeti, i Cili e pyes-te për gjendjen e tij:

-Shko dhe thuaju atyre që ke lënë pas! Në qoftë se janë gjallë brenda një kohe sa hap e mbyll sytë dhe brenda kësaj kohe i ndodh ndonjë gjë të Dërguarit të Allahut, në botën tjetër dy duart e mia do ti kenë në fyti! (Muvatta, Xhihad, 41; Ibn Abdilberr, Istiab, II, 590)

Ja besnikëria...ja sinqeriteti në besnikëri...

Ky tregim në lidhje me mikun e Allahut Ebubekir Shibli është shembullor në aspektin sesi duhet të jetë miku besnik:

Ebubekir Shibli ishte një njeri i urtë, i cili i shihte ngjarjet në mënyrë që të merrte mësim. Nganjëherë kur donte të jepte ndonjë mesazh, e bënte këtë duke krijuar ndonjë ndodhi të rastit. Një ditë i pyet miqtë e tij:

-A më doni mua sinqerisht?

Iu përgjigjën të gjithë së bashku:

-Zotëri, vetëm të na pyesni për këtë, bile na vjen rëndë. A keni dyshime për dashurinë tonë të palëkundur?

Pas kësaj, Shibli mori copa drunjsh dhe filloi ti gjuante shokët e tij, kur pa që ata filluan të largoheshin duke thënë:

-I iku mendja këtij më duket!

I pyeti përsëri:

-O miqtë e mi të palëkundur, ku shkoni kështu?

I thanë:

-Ku tjetër, në shtëpitë tona!

-Po ju më donit! Pse po më braktisni?

-Zotëri, ju na lënduat duke na plagosur në kokë e sy me copat e drunjve që hodhët. Kështu që s’kemi si rrimë pranë jush.

Shibli buzëqeshi e tha:

-Ejani, ejani. O shokët e mi të rremë!, dhe shtoi: “E veçanta e miqësisë është kjo që edhe të të vijë e keqja nga miku yt, do ta futësh në krahëror; edhe po të vijë vuajtja, do ta pranosh. Sikur ju të ishit miqtë e mi të vërtetë, kur të shihnit ndonjë sjellje shqetësuese tek unë, do të duronit dhe të përpiqeshit të më përmirësonit, nuk do të zgjidhnit të iknit.”

Kështu i mblodhi sërisht rreth tij miqtë, të cilët nuk e kishin kaluar provimin. U munduan të përfitonin nga ligjëratat dhe këshillat e tij. Si dhe mësuan, për të mos e harruar kurrë kushtin e miqësisë me anë të një shembulli të tillë performues të jetuar personalisht.

Besnikëria e Profetit, besnikëria e sahabëve të nderuar, besnikëria e miqve të Allahut... baza është një besnikëri e ndërtuar mbi durim dhe sinqeritet të fortë e të palëkundur, pavarësisht kushteve.

Besnikëria jonë duhet të jetë një besnikëri, e cila nuk lëkundet nga asnjë lloj oferte dhe nga asnjë lloj shqetësimi apo vështirësie me të cilën sprovohehi. Apo jo? Mirëpo, a është kaq besnike besnikëria jonë ndaj Profetit tonë dhe fesë që ai ka shpjeguar?



MUHAMEDI

-salallahu alejhi ve selem -
në sytë e Perëndimit

Emine Babçe

*"Edhe pse kanë kaluar 14 shekuj,
Hz. Muhamedi është udhëzuesi
i vetëm i njerëzimit."*

(Rajmons Leronge)



"Muhamedi është njeriu që duhet dëgjuar më shumë se gjithë të tjerët. Përpara mësimave të Tij çdo fjalë tjetër është pa vlerë." (Thomas Carlyle)

"Çdo fjalë e Tij është një parim." (Prof. Dr. H. Momenes)

"Ai është një peygamber i drejtë, i dërguar nga Allahu." (Aleksi Lovazon)

"O i madhi Muhamed! Me drejtësinë tënde ke arritur një majë të tillë, që nuk e ka arritur askush përpara teje dhe as nuk do ta arrijë më kurrë!.." (La Fayette)

"Unë, personalisht jam një tifoz i Muhamedit." (Sociologu V. D. Eratsen)

"Muhamedi është lideri më i madh i të gjitha kohërave." (Prof. Zhules Masserman)

"Muhamedi është njeriu që ka arritur suksesin më të madh të të gjitha kohërave nga ana fetare dhe njerëzore." (Prof. Dr. Michael Hart)

"Muhamedi meriton respekt të madh." (Tolstoi)

"Muhamedin nuk e duan vetëm ata që nuk e njohin

aq sa duhet." (Gibson)

"Peygamberi i madh i fesë islame është ngjitur pranë Krijuesit dhe është takuar me Të. Unë i besoj plotësisht Miraxhit." (Dostojevski)

"Kritikat që janë bërë për jetën dhe karakteret e prijësve të mëdhenj nuk bëhen për Peygamberin e fesë islame." (B. Smith)

"O Muhamed, më vjen shumë keq që nuk kam jetuar në shekullin Tënd!.. Kurani është libri i Allahut. Një person si ti, kjo botë e ka parë vetëm një herë dhe nuk do ta shohë më kurrë. Unë përkulem përpara teje me respekt." (Princi Bismark)

"Askush nuk mund të përparojë më shumë se ndjekësit e Muhamedit (a.s.). Ne popujt evropianë, bashkë me mundësitë tona të zhvilluara, jemi vetëm në fillim të shkallëve, majën e të cilave e ka arritur Muhamedi. Nuk ka asnjë dyshim se askush nuk do ta kalojë Atë në këtë garë." (Gëte)

"I gjithë njerëzimi mburret me Muhamedin. Ne evropianët jemi me fat, që pas 2000 vitesh arritëm të njihemi me vlerën dhe vërtetësinë e Tij." (Shebol)

"Unë e kam studiuar jetën e këtij njeriu të mahnit-



shëm. Sipas meje, Ai duhet të njihet si shpëtimtari i njerëzimit." (Bernard Show)

"Le të matet në çdo mënyrë madhështia e një njeriu... Askush nuk është më i përsosur se Ai." (Lamartine)

"Dua ta them me të madhe diçka që të gjithë kanë turp ta pranojnë. Muhamedi është një revolucionar, me të cilin nuk mund të matet askush." (Knematirul)

"Ekzistencën e Zotit, Musai ia transmetoi të gjithë fisit të vet, Isai të gjithë Romës, kurse Muhamedi të gjithë botës." (Napoleon Bonaparti)

"Duhet ta pranoj se feja e Muhamedit i shkon Afrikës më shumë se kristianizmi. Në fakt, duhet të them se kjo është e vlefshme për të gjithë botën. Shkurtimisht mund të themi se ajo është feja që e bën njeriun njeri. Islami nuk ka si qëllim ta bëjë njeriun të përkryer si një perëndi, por mundohet që ta bëjë atë të paktën një fqinj të mirë." (Lawton Lancelot)

"Muhamedi (a.s.), ka qenë ndikuesi më i madh i njerëzimit." (John Draper)

"Ne nuk habitemi nga përhapja e fesë së Tij, por nga stabiliteti që Ai krijoi... Shekuj më vonë feja e Tij nuk ndryshoi, mbeti e njëjtë në mesin e indianëve, afrikanëve dhe turqve." (Edward Gibbon)

"Pas një periudhe, gjatë së cilës unë lexova për jetën e Pejgamberit të fesë islame, kuptova se ai kurrsesi nuk mund të jetë një pejgamber i rremë." (Gëte)

"Të gjitha sjelljet e Tij, jeta e përditshme janë bërë si një kushtetutë që miliona njerëz e ndjekin me vetëdije të plotë. Të gjithë e pranojnë se gjatë gjithë jetës së tij ai ka qenë: "Njeriu Perfekt". Ai është ndjekur dhe imituar me detaje. Sjelljet e krijuesit të kristianizmit nuk i kanë dhënë drejtim jetës së përditshme të besimtarëve të thjeshtë. Për më tepër që asnjë drejtues fetar nuk ka lënë besim dhe siguri pas tij siç ka bërë Profeti (a.s.)." (D. G. Hogart)

"Atij i kanë thënë pejgamber, apo jo? Pse? Sepse Hz. Muhamedi ka folur ballë për ballë me ta, nuk është fshehur pas asnjë misticizmi, ka bërë fasho nga trikoja e vet, ka rregulluar këpucët e veta, ka luftuar me ta dhe i ka këshilluar gjithmonë. Ju mund të thoni çfarë të doni për Të, por të gjithë e kanë kuptuar se sa njeri i lartë është Ai. Njerëzimi nuk ka shikuar kurrë një perandor që mban

një kurorë hyjnore të bëjë fasho nga trikoja e vet. Tek ai shikoj një hero të vërtetë, që ka arritur maksimumin e asaj që mund të arrihej brenda njëzet e tre vitesh përpjekjesh." (Thomas Carlyle)

"Besimi i ri që solli Muhamedi ka pastruar të paqartën nga dyshimi dhe Kurani është një dëshmitar i mrekullueshëm i ekzistencës së Allahut." (Edward Gibbon)

"Muhamedi ishte mendimtar, ligjërues, mbrojtës i së drejtës, ushtar, zbulues idesh, dhe dallues i së drejtës. Sikur matja e madhështisë së një njeriu të ishte e mundur, ne pyesim: "A mund të ekzistojë një njeri më i lartë se Ai!." (Lamartin)

"Sipas mendimit tim, besimi i Muhamedit, ashtu siç ka filluar të pranohet në Evropë ditët e sotme, ashtu do të vazhdojë të pranohet edhe në të ardhmen. Kisha e mesjetës, nga padituria ose nga fanatizmi e tregoi Muhamedin të errësuar me bojë të zezë. Ata u mësuan ta urrenin Muhamedin dhe fenë e tij. Sipas tyre, ai ishte i kundërt me Isain. Unë e kam studiuar atë njeri të mrekullueshëm. Atij nuk mund t'i themi kundërshtar i Isait, ai është vetëm shpëtimtar i njerëzimit. Sikur bota e sotme të ishte nën sundimin e tij, jam i sigurt se pjesa më e madhe e problemeve do të gjenin zgjidhje. Evropa ka filluar ta ndjejë dashurinë ndaj Muhamedit. Në vitin e ardhshëm, zgjidhja e të gjitha problemeve të kësaj bote mund të realizohet vetëm prej kësaj feje." (George Bernard Show)

"Pejgamberi i fundit, Muhamedi erdhi në jetë në qytetin e Mekes, në një kohë kur bota ndodhej në injorancë dhe feja e Ibrahimit kishte filluar të zhdukej. Ai iu dërgua njerëzimit për të qenë ndërmjetës dhe mëshirues. Ai është njeriu më i përsosur i të gjitha kohërave. Që ditën që jam bërë mysliman, unë kam studiuar rreth jetës së Tij. Teksa e lexoj dhe e kuptoj Atë, bëhem i vetëdijshëm për injorancën dhe paditurinë që më rrethonte." (Cat Stevens- Jusuf Islam)

"Do të doja të më tregoni një njeri që është akoma në jetë dhe që ka një ndikim shumë të madh mbi miliona persona. Kam kuptuar se Islami i ka pushtuar vendet jo me shpatë, por me mënyrën e jetesës. Fitoret Atij ia kanë dhënë: shoqëria që kishte me të tjerët dhe sakrificat që bënte për to; modestia, trimëria dhe lidhja e fortë që kishte me Zotin. Shpata nuk kishte asnjë vlerë." (Mahatma Gandhi)



Meblika Dogan

Morali i TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

- salallahu alejhi ve selem -



Morali i bukur, dituria, modestia, devotshmëria dhe cilësi të tjera si këto janë virtyte të zemrave të pastra.

Në ajetin kuranor thuhet:

"Pa dyshim, ti do të jesh përherë i shpërblyer se ti je me virtyte madhore." (Kalem, 3-4)

Në këtë mënyrë lartësohet morali i lartë i Pejgamberit tonë.

Pejgamberi (a.s.), e ka shprehur kështu qëllimin me të cilin Ai është dërguar në këtë botë:

"Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e bukur." (Muvatta, Husnul Huluk, 8)

Për të përshkruar dhuratat që i ka dhënë Allahu (xh. sh.), Ai ka thënë:

"Mua më ka edukuar Zoti im; sa e bukur është edukata ime." (Sujuti, Xhamius Sagir, I, 12)

Kjo do të thotë që edukata e Pejgamberit (a.s.), ka ardhur nga një moral i lartë hyjnor. Pejgamberi (a.s.), ka fatin që ka marrë pjesë nga morali hyjnor. Ja se si e kanë shpjeguar moralin e Tij të lartë sahabët dhe të afërmit e tjerë:

Hz. Aishe (r.a.), tregon:

"Morali i Tij ishte Kurani. Ai ishte dakord me gjërat të cilat i pranonte Kurani dhe nuk bënte gjërat që Kurani nuk i pëlqente." (Muslim, Musafirin, 139; Nesai, Kijamul Lejl, 2)

Pejgamberi ynë i nderuar kishte humbur gjyshin kur kishte qenë i vogël. Një ditë Hz. Hysejni i kishte kërkuar Hz. Aliut që t'i fliste për gjyshin e vet. Hz. Aliu, që ishte njëkohësisht edhe djali i xhaxhait edhe dhëndri i Pejgamberit (a.s.), i kishte dhënë këtë përgjigje:

"Resulullahu ishte njeri me fytyrë të buzëqeshur, me virtyte, me zemër të butë. Ai nuk ishte i egër dhe i ashpër. Nga goja e Tij nuk ka dalë kurrë asnjë fjalë e keqe. Ai nuk tallej me veprimet e të tjerëve. Resulullahu largohej nga tri gjëra:

1- Mosmarrëveshja dhe lufta.

2- Thënia e më shumë fjalëve se ç'ishte e nevojshme.

3- Marrja me gjëra të parëndësishme.

Ndërsa në marrëdhëniet me të tjerët ruhej për tri gjëra:

1- Nuk kritikonte askënd me fjalë të rënda.

2- Nuk fyente askënd.

3- Nuk përpiqej të mësonte të fshehtat e të tjerëve, nuk spiunonte.

Profeti (a.s.), diskutonte vetëm për tema të cilat i sillnin dobi shoqërisë. Kur fliste Resulullahu, të gjithë sahabët heshtnin dhe ulnin kokën për ta dëgjuar. Kur dikush thoshte diçka, i Dërguari i Allahu e dëgjonte me vëmendje. Kur njerëzit qeshnin edhe ai qeshte, në të shumtën e kohës Ai buzëqeshte. Nëse një njeri i panjohur i thoshte një fjalë të rëndë, Resulullahu e dëgjonte me vëmendje. Nuk kishte dëshirë ta lavdëronin, por i pranonte falënderimet e një njeriu të cilit i kishte bërë një të mirë. Pejgamberi (a.s.), nuk ia priste fjalën askujt. Ai ishte një njeri shumë dashamirës, i drejtë, me zemër të pastër dhe të butë. Njerëzit që e shikonin për herë të parë, dridheshin para moralit të Tij të lartë; ata mahniteshin para Tij dhe kërkonin të krijonin shoqëri me Të.

Hind bin Ebi Hale i përshkruan kështu cilësitë e Pejgamberit tonë të dashur:

"Ai ishte njeri me zemër të butë. Nuk kishte qejf të turpëronte askënd. Kur dikush nuk i pranonte të vërtetat e Islamit, Ai merrej me të gjithë natën dhe mendohej ta bindte për rrugën e drejtë. Kurse në rastet kur dikush i bënte Atij personalisht diçka të padrejtë, Resulullahu nuk mërzitej asnjëherë. Nuk hakmerrej për të këqijat që i bënin njerëzit. Kur mërzitej me dikë, nuk ia përplaste në fytyrë këtë gjë." (Shemali Tirmidhi)



Shijoni cilësinë...

RISTI!

Produkt
natyral
HALLALL



Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHITIT 2005



KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR

CILËSI E VËRTETUAR



Jogurtat me përmbajtje të kulturave *Bio Active* Në Kosovë prodhohet vetëm nga qumështorja "ABI"

Probiotic
drink



www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address: "Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail: abi@abimilk.com

www.abimilk.com

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës

Numri i licencës : AVUK-001

"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033